

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5897  
E hënë, 7 tetor 2019  
çmimi 0.40 €

Liderët: 6 tetori, ditë e rëndësishme për të ardhmen e Kosovës



FAQE 3

Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE TË 6 TETORIT KANË PËRFUNDUAR NË MËNYRË TË RREGULLT | FAQE 4-5

## LËVIZJA VETËVENDOSJE, FITUESE E ZGJEDHJEVE



Prej 80 për qind të votave të numëruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ-ja), Lëvizja Vetëvendosje, e drejtuar nga Albin Kurti, ka fituar zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit me një epërsi të ngushtë ndaj

Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK-së). Partia Demokratike e Kosovës (PDK-ja) ka dalë në vendin e tretë, pas saj koalicioni AAK-PSD dhe, si duket, edhe koalicioni Nisma-AKR-PD deri në numrin e përgjithshëm të votave do ta kalojë prapë. Kryetari i

PDK-së, Kadri Veseli, ka pranuar humbjen e zgjedhjeve dhe ka bërë me dije se PDK-ja do të dalë në opozitë. Sipas të dhënave preliminare, në zgjedhjet e së dielës kanë marrë pjesë 812 mijë e 49 qytetarë apo 44.18 për qind

### AKTUALE



**BIEBER: PERSPEKTIVAT E REJA VAREN NGA KRIJIMI I KOALICIONEVE NË KOSOVË** F. 11

**ÇKA E PRET QEVERINË E ARDHSHE TË KOSOVËS?** F. 6

**SHËNOHET 'DITA E GËSHTENJËS' NË DEÇAN** F. 10

**QKUK-ja PËRMES INVESTIMEVE SYNON TA KTHEJË BESIMIN TE PACIENTËT** F. 11

### EKONOMI



**300 QYTETARË PRITET TA MARRIN LEJEN E LEGALIZIMIT NË DURRËS, KAVAJË DHE PESHKOPI** F. 9

### SPORT

**MANAJ: KUJDES NGA 'NIKLI', ËSHTË KAMPION NË FUQI** F. 18

**MANAJ: KUJDES NGA 'NIKLI', ËSHTË KAMPION NË FUQI** F. 18

FLET PËR "EPOKËN E RE", ARDIAN SYLA | FAQE 8-9



## Partneriteti publiko-privat, forma më e përshtatshme për investime në 'Trepçë'

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Vite, p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



## Hahn: BE-ja t'i hapë negociatat për Shqipërinë e Maqedoninë e Veriut



Tiranë, 6 tetor - Komisarit evropian i Zgjerimit, Johannes Hahn, ka konfirmuar edhe një herë mbështetjen e tij për hapjen e negociatave në tetor për anëtarësimin e Shqipërisë dhe Maqedonisë së veriut në Bashkimin Evropian. "Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut i janë përgjigjur reformave të kërkuara, tani është koha që edhe shtetet anëtare të përgjigjen.

Faleminderit drejtuesve të BE-së për qëndrimin e fortë për hapjen e negociatave të pranimit me të dy vendet në tetor", ka thënë Hahn.

Kujtojmë që vetëm tri ditë më parë drejtuesit e institucioneve më të larta të Bashkimi Evropian iu drejtuan shteteve anëtare me një letër ku kërkonin të japin dritën jeshile për hapjen e negociatave për anëtarësim me

Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.

Në letrën e firmosur nga 4 presidentët, Tusk, Sassoli, Juncker dhe Von der Leyen, theksohet se "nëse Bashkimi Evropian vendos tani për t'i filluar bisedimet e pranimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë është një provë e aftësisë së Unionit për të përbushur premtimet e tij dhe për të parë të ardhmen".

## Anëtarësimi në BE, Shqipëria dhe Maqedonia Veriore mund t'i ndajnë rrugët

Agjencia "Reuters" thotë se dy mundësi janë të mundshme, njëra është të vendosen kushte shtesë para se të fillojnë bisedimet për anëtarësimin në BE, tjetra është që të ndahen Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria

PRISHTINË, 6 TETOR - Gjermania propozon ndarjen e Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë në procesin e integritit evropian, si një përpjekje për të arritur një kompromis midis të gjitha vendeve anëtare të BE-së më 15 tetor, kur do të vendosë për një datë të re për ato vende që t'i fillojnë bisedimet e anëtarësimin në BE, raporton "Reuters".

Agjencia thotë se dy mundësi janë të mundshme, njëra është të vendosen kushte shtesë para se të fillojnë bisedimet, tjetra është që të ndahen Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria.

Bazuar në një plan të propozuar këtë javë për ministrat e 28 vendeve anëtare të BE-së për të diskutuar në mes të tetorit për çështjen e një date të BE-së për bisedime me Maqedoninë Veriore dhe Shqipërinë, një kompromis është i mundur midis atyre që përipiqen të shkojnë më pranë Ballkanit dhe atyre

që rezistojnë, si Franca, Holanda dhe Danimarka.

"Reuters" kujton se Gjermania votoi dy javë më parë për t'i filluar negociatat e BE-së me Maqedoninë Veriore dhe Shqipërinë, por me kushte shtesë për Tiranën.

Përfundimet e Këshillit të Ministrave sugjerojnë që Maqedonia Veriore t'i fillojë negociatat më vonë këtë vit, por jo Shqipëria. Siç thuhet, "në funksion të përparimit të bërë, BE-ja ka vendosur t'i hapë negociatat e pranimit me Maqedoninë Veriore", duke shtuar se konferenca e parë ndërqeveritare do të mbahet deri në fund të vitit 2019.

"Reuters" shtoi se megjithëse në projekt-konkludim kishte të njëjtën fjali për Shqipërinë, ajo u hoq në versionin e fundit dhe nuk jep një datë për konferencën e parë ndërqeveritare me Tiranën. Përkundrazi, ai numëron disa kërkesa gjyqësore



dhe antikorrupsion që Shqipëria duhet t'i përbushë. Një diplomat tha për "Reuters" se miratimi i këtyre përfundimeve do të varet nga Franca, për të cilat presidenti Emmanuel Macron do të vendosë personalisht.

Në tekst thuhet se Holanda, si një vend me rezerva të mëdha për zgjerim, është më shumë në favor të Maqedonisë Veriore për marrjen e një date sesa Shqipëria.

Edhe pse vendimi pritet të miratohet në Luksemburg më 15

tetor, nuk përjashtohet që çështja të zhvendoset në nivelin e samiteve të krerëve të shteteve dhe qeverive, ku kancelarja gjermane Angela Merkel dhe presidenti francez Emmanuel Macron do të përipiqen të arrijnë një kompromis.

## Erdogani sot në Beograd

ANKARA, 6 TETOR - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, sot (e hënë) do ta vizitojë Serbinë për të marrë pjesë në takimin e dytë të Këshillit të Bashkëpunimit të Nivelit të Lartë Turqi-Serbi, transmeton Anadolu Agency (AA).

Në një deklaratë nga Presidenca turke mësohet se në takimin e dytë të Këshillit të Bashkëpunimit të Nivelit të Lartë Turqi - Serbi që do të kryesohet nga Erdogani dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, do të marrin pjesë edhe

ministra dhe zyrtarë përkatës.

Gjatë takimeve do të rishikohen në mënyrë gjithëpërfshirëse në të gjitha dimensionet marrëdhëniet dypalëshe, do të diskutohen hapat që mund të hidhen për thellimin e bashkëpunimit si dhe do të shkëmbehen pikëpamjet rreth çështjeve rajonale dhe ndërkombëtare.

Në kuadër të vizitës nga 7-8 tetor e cila ka një rëndësi të veçantë për shkak se do të zhvillohet në një periudhë kur festohet 140-vjetori i ndërtimit të marrëdhënieve

diplomatike Turqi - Serbi, do të zhvillohet edhe Forumi i biznesit Turqi - Serbi.

Gjatë vizitës krahas hapjes së projekteve të realizuara në Serbi nga TIKA, planifikohet që të zhvillohen edhe ceremoni të ndryshme për inaugurime dhe hapjen e fabrikave të ngritura nga kompanitë turke.

Në kuadër të vizitës, pritet që me pjesëmarrjen e presidentit Erdogan, presidentit serb, Vuçiq dhe kryetarit të Këshillit Presidencial të Bosnjë e



Hercegovinës, Zhelko Komshiq në Beograd të zhvillohet edhe Samiti trepalësh Turqi-Bosnjë e Hercegovinë-Serbi, i cili është formuar me qëllim përmirësimin

e paqes dhe stabilitetit në Ballkan. Me rastin e samitit dhe pjesëmarrjen e liderëve pritet të zhvillohet edhe ceremonia e fillimit të autostradës Sarajevë - Beograd.



Hedhin votën e tyre liderët e institucioneve shtetërore dhe kandidatët për kryeministër

# Liderët: 6 tetori, ditë e rëndësishme për të ardhmen e Kosovës

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi dhe kandidatët për kryeministër, Vjosa Osmani, Kadri Veseli, Albin Kurti dhe Fatmir Limaj, kanë shfrytëzuar të drejtën e votimit në zgjedhjet parlamentare të së dielës. Me këtë rast ata kanë thënë se 6 tetori është një ditë e rëndësishme për të ardhmen e vendit. Sipas tyre, këto zgjedhje duhet të shërbejnë për një mirëqenie më të mirë për qytetarët



EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

**PRISHTINË, 6 TETOR** - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka votuar të dielën në zgjedhjet e parakohshme parlamentare duke uruar që këto zgjedhje të jenë për të ardhmen e sigurt euroatlantike të Kosovës dhe për një jetë më të mirë të qytetarëve. "Kjo është ditë shumë e rëndësishme për demokracinë tonë dhe të gjithë qytetarët duhet ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre për të zgjedhur. Uroj që këto zgjedhje të jenë zgjedhje për të ardhmen e sigurt euroatlantike të Kosovës, për një jetë më të mirë, për zhvillim ekonomik, për vende të punës dhe mirëqenie më të mirë për të gjithë qytetarët", ka deklaruar Thaçi pas votimit në shkollën "Faik Konica".

Të drejtën e votës e ka shfrytëzuar edhe kryeministri në largim, njëherësh kandidati për kryeministër nga radhët e koalicionit AAK-PSD, Ramush Haradinaj, në shkollën "Ali Sokoli". Ai ka thënë se dalja masive në zgjedhje dhe procesi transparent garantojnë se Kosova ka marrë drejtimin e duhur. "Këtë mëngjes, Anita dhe unë, e kemi kryer obligimin qytetar, duke shprehur me votë vullnetin tonë për Kosovën që duam. U bëj thirrje të gjithë qytetarëve të vendit me të drejtë vote, t'u drejtohen kutive të votimit për t'i zgjedhur përfaqësuesit e tyre në Kuvendin e Kosovës, për mandatin e ardhshëm katërvjeçar, duke ushtruar të drejtën dhe obligimin e vet ligjor dhe demokratik. Pas një fushate parazgjedhore që manifestoi pjekuri politike dhe vullnet për transformimin e shoqërisë dhe forcimin e shtetit, dalja masive në zgjedhje dhe kujdesi që ato të

jenë transparente, korrekte dhe të drejta, garantojnë se Kosova ka marrë drejtimin e duhur", është shprehur Haradinaj.

Edhe kandidati për kryeministër i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka hedhur votën e tij në shkollën "Faik Konica". Me këtë rast ai ka thënë se zgjedhjet janë ngjarje e rëndësishme për të tashmen dhe të ardhmen e qytetarëve. "I bëj thirrje gjithkujt që është përfshirë në procesin zgjedhor, që të angazhohet maksimalisht për të garantuar zgjedhje sa më të rregullta e të qeta duke respektuar të drejtën e kujtdo për të votuar. Ftoj të gjithë qytetarët që të dalin të votojnë pa ngurrim për fatin e tyre dhe të vendit tonë duke dëshmuar që Kosova është një shtet evropian me demokraci të konsoliduar", ka theksuar Veseli. Po ashtu, edhe kandidati për kryeministër nga Lëvizja Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, ka votuar në Fakultetin Juridik, i shoqëruar nga gruaja dhe vajza. Ai ka thënë se është një ditë e veçantë kur flet populli. "Dita sot është fort e veçantë, të gjitha partive dhe politikanëve u përgjigjet populli si burim i sovranitetit të republikës sonë. Sot nuk ka rëndësi a je i pasur a i varfër, a je grua a je burrë, a je i ri apo i moshuar, a vjen nga fshati apo nga qyteti, a ke mbaruar shkollë të lartë apo jo, të gjithë jemi të barabartë, prandaj unë u bëj thirrje të gjithë qytetarëve me të drejtë vote që ta shfrytëzojnë shansin unik për nga karakteri historik për nga pesha", ka thënë Kurti.

Gjithashtu, edhe kandidatja e LDK-së për kryeministër, Vjosa Osmani, e ka kryer obligimin e vet qytetar. Ajo, e shoqëruar nga bashkëshorti, ka votuar në Fakultetin Teknik. Osmani ka

vlerësuar se 6 tetori është ditë historike dhe vendimtare për të ardhmen e Kosovës. "Të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës duhet të bëhen pjesë e këtij vendimi historik sepse vërtet kjo është një ditë historike dhe vendimtare për të ardhmen e Kosovës. Besoj shumë se nëpërmjet një procesi korrekt, të lirë dhe demokratik Kosova do të ketë arsye për të festuar", ka theksuar Osmani.

Votën e ka hedhur edhe kandidati për kryeministër nga koalicioni Nisma-AKR-PD, Fatmir Limaj. Ai ka thënë se procesi zgjedhor do t'i japë siguri, perspektivë dhe mundësi të jashtëzakonshme vendit. "Kjo mundësi duhet të shfrytëzohet, në këtë ditë me diell për të dalë e votuar. Jam i bindur dhe shpresoj se vota e qytetarit do të jetë siguri e vendit, perspektivë dhe mundësi e jashtëzakonshme për t'i bërë hapat e duhur", ka theksuar Limaj.

Të drejtën e votës e ka shfrytëzuar edhe kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, në shkollën "Emin Duraku". Ai ka thënë se pjesëmarrja në zgjedhje fuqizon qeverisjen e vendit. "Është një ditë tepër e rëndësishme për Kosovën, ku qytetarët vendosin për fatin e tyre dhe për qeverisjen e tyre. Unë kam besim te qytetarët, kam besim se Kosova do të ecë përpara", ka thënë Mustafa.

Në zgjedhjet e së dielës ka votuar edhe presidenti i Aleancës Kosova e Re (AKR), Behgjet Pacolli, duke thënë se vota e qytetarëve është e rëndësishme. "Uroj për një qeveri që e do Kosovën dhe popullin e saj, e sidomos të rinjtë. Uroj që procesi zgjedhor të shkojë sa më mirë", ka thënë Pacolli. Votën e ka hedhur edhe lideri i Partisë Socialdemokrate (PSD), njëherësh kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti.





Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit kanë përfunduar në mënyrë të rregullt

# Lëvizja Vetëvendosje,

Prej 80 për qind të votave të numëruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ-ja), Lëvizja Vetëvendosje, e drejtuar nga Albin Kurti, ka fituar zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit me një epërsi të ngushtë ndaj Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK-së). Partia Demokratike e Kosovës (PDK-ja) ka dalë në vendin e tretë, pas saj koalicioni AAK-PSD dhe, si duket, edhe koalicioni Nisma-AKR-PD deri në numrin e përgjithshëm të votave do ta kalojë prapun. Kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, ka pranuar humbjen e zgjedhjeve dhe ka bërë me dije se PDK-ja do të dalë në opozitë. Sipas të dhënave preliminare, në zgjedhjet e së dielës kanë marrë pjesë 812 mijë e 49 qytetarë apo 44.18 për qind

**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 6 TETOR** - Lëvizja Vetëvendosje ka dalë fituese e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 6 tetorit pas numërimit të mbi 80 për qind të votave. Pas saj radhitet LDK-ja me një diferencë të vogël. Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka dalë në vendin e tretë, pas saj koalicioni AAK-PSD dhe, si duket, edhe koalicioni Nisma-AKR-PD deri në numrin e përgjithshëm të votave do ta kalojë prapun. Kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, ka pranuar humbjen e zgjedhjeve dhe ka bërë me dije se PDK-ja do të dalë në opozitë. Edhe Demokracia në Veprim e ka nxjerrë fituese LV-në. Pas mbylljes së vendvotimeve dhe publikimit të këtyre rezultateve kanë reaguuar të gjitha subjektet politike që kanë qenë në garë.

Zyrtarët e LV-së, të LDK-së dhe të PDK-së kanë deklaruar se janë ftues të këtyre zgjedhjeve, ndonëse kanë preferuar që të priten rezultatet preliminare të numërimit të votave. Shefi i shtabit zgjedhor i LV-së, Besnik Bislimi, në një konferencë për medie ka thënë se fitorja e kësaj partie është e sigurt. "Raportimet që kemi nga komisionarët tanë dhe nga vëzhguesit e Exit polit e nxjerrin Lëvizjen Vetëvendosje fituese. Por, fitorja është në kutitë e votimit", ka thënë Bislimi.

Kurse nënkryetari i LDK-së, Lutfi Haziri, në një konferencë për media ka deklaruar se partia e tyre është fituese e këtyre zgjedhjeve. "Sipas mostrave që i kemi marrë nga stafi profesional, LDK-ja është parti fituese e këtyre zgjedhjeve. LDK-ja është partia e parë me mbështetje nga qytetarët në

këto zgjedhje. Natyrisht ne jemi të lumtur që si bllok opozitar kemi mundur të shënojmë rezultat shumë të thellë. Rezultatet tregojnë se LDK-ja ka përparësi në udhëheqje ndaj Vetëvendosjes si parti e dytë. Presim tash që deri në 9:30 minuta të kemi një qartësi të madhe se sa është ky dallim mes nesh dhe partisë së dytë", ka deklaruar Haziri.

Edhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka pretenduar se është fituese e këtyre zgjedhjeve. Në një konferencë për media, zyrtari i lartë i kësaj partie, Abelard Tahiri, ka thënë se informatat nga terreni flasin se kjo parti është fituese e zgjedhjeve. "Nga të gjitha informacionet që kemi nga terreni, PDK-ja do të jetë partia e parë, por presim një fitore më të vogël se zakonisht", ka thënë Tahiri.

Rezultatit e zgjedhjeve nuk ka dashur ta komentojë lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj. Në një konferencë për medie ai ka thënë se AAK-ja ka shënuar rritje në këto zgjedhje. "Dua t'i veçoj tri çaste nga ky proces zgjedhor. Së pari, është treguar pjekuri dhe procesi ka shkuar shumë mirë. Pastaj, është votu-



ar vetëm me dokumente të Republikës së Kosovës, që ndodh për herë të parë dhe është gjë pozitive. Dhe, së fundmi, u vërtetua se është më së miri kur vullneti i kthehet sovranit dhe ai vendos për të ardhmen e vet", ka thënë Haradinaj. Ndërsa lideri i Nismës, Fatmir Limaj, ka thënë se subjekti i tij politik do të jetë parti vendimtare për qeverisjen e

ardhshme të Kosovës. "Tash i kemi shtatë deputetë dhe po luftojmë për deputetin e tetë në bazë të të gjitha informacioneve që kemi nga terreni", ka thënë Limaj.

**KQZ-ja: Procesi zgjedhor ishte i rregullt, 44.18 për qind dalja e qytetarëve në zgjedhje**

Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, ka bërë me dije se, sipas të dhënave preliminare, në zgjedhjet e së dielës kanë marrë pjesë 812 mijë e 49 qytetarë apo 44.18 për qind. Në një konferencë për medie të mbajtur pas mbylljes së vendvotimeve, ajo ka thënë se procesi ka qenë i rregullt dhe pa incidente të cilat do të mund t'i cenonin zgjedhjet. Po ashtu, Daka ka treguar se të gjitha vendvotimet janë hapur dhe janë mbyllur me kohë. "Duke u mbështetur në informacionet e komisioneve komunale të zgjedhjeve janë mbyllur të

gjitha vendvotimet dhe tani ka filluar procesi i fletëvotimeve. Sipas të dhënave preliminare, nga 2 418 vendvotimeve apo rreth 95 për qind e tyre, numri i qytetarëve që kanë votuar është 812 mijë e 49 votues ose 44.18 për qind. Deri në të njëjtën kohë në zgjedhjet e kaluara të parakohshme të vitit 2017 kishin votuar 759 549 votues ose 41.45 për qind", ka deklaruar Daka. Ajo ka inkurajuar anëtarët e këshillave të vendvotimeve që gjatë procesit të zbatojnë të gjitha procedurat e numërimit me qëllim që vullneti i qytetarëve të Kosovës të respektohet.

Për mbarëvajtjen e zgjedhjeve Daka ka falënderuar Policinë e Kosovës, Prokurorinë e Shtetit si dhe OSBE-në. "Në emër të KQZ-së inkurajoj anëtarët e këshillave të vendvotimeve që gjatë procesit të numërimit të fletëvotimit t'i zbatojnë të gjitha procedurat e numërimit me qëllim që vullneti i qytetarëve të Kosovës të respektohet. Falënderoj institucionet e Republikës së Kosovës,

## Ambasada e ShBA-së në Kosovë, e kënaqur me ecurinë e zgjedhjeve

Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë është shprehur e kënaqur me ecurinë e procesit zgjedhor të së dielës. Në llogarinë e kësaj ambasade në "Facebook" është shkruar se mbarëvajtja e zgjedhjeve dëshmon për një angazhim të fortë për të ardhmen e Kosovës. "Çfarë dite e shkëlqyeshme, kënaqësi kur sheh kaq shumë prej jush duke marrë kohë për të votuar. Kjo dëshmon angazhimin tuaj të fortë për të ardhmen e Kosovës. Kosova është shtëpia juaj", është shkruar në llogarinë e Ambasadës së ShBA-së në "Facebook".



# fituese e zgjedhjeve



Policinë e Kosovës, Prokurorinë e Shtetit për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor si dhe misionin e OSBE-së në Kosovë për ndihmën e dhënë", është shprehur Daka, duke shtuar se pas mbylljes së vendvotimeve ka filluar edhe procesi për ankesa në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP).

## Partitë kanë denoncuar njëra-tjetrën

Gjatë ditës së zgjedhjeve subjektet politike vazhdimisht kanë akuzuar njëra-tjetrën se po mundohen ta deformojnë vullnetin e qytetarëve. E para që ka reaguar ka qenë PDK-ja e cila e ka kritikuar LDK-në për manipulim të votuesve në Sllatinë të Fushë-Kosovës, duke ushtruar ndikim e presion te qytetarët për mënyrën se si ata të votojnë. Më pas, PDK-ja ka mbajtur edhe konferencë për medie, ku zyrtari i lartë i PDK-së, Abelard Tahiri, e ka akuzuar Lëvizjen Vetëvendosje për blerje të votave. "Besoj e keni parë të

gjithë, sepse ishte përmes medieve, se si është filmuar kryetari i Vetëvendosjes në Pozharan të Vitisë duke blerë vota. Këto janë shkelje të rënda. Dhe, gjithashtu, përveç Vetëvendosjes, në Zhabar të Mitrovicës janë parë edhe zyrtarë të LDK-së duke bërë presion te qytetarët dhe duke u përpjekur ta deformojnë vullnetin e tyre. Me këtë rast u bëjmë thirrje të gjithë komisionarëve tanë që të mos bien pre e provokimeve dhe ta ruajnë qetësinë, duke mbledhur fakte për ta raportuar çdo shkelje ligjore që bëhet, në mënyrë që të garantohet zbatimi i plotë i ligjit", ka thënë Tahiri.

Edhe Lidhja Demokratike e Kosovës ka dhënë kritika për rivalët politikë, duke iu bërë thirrje të gjitha institucioneve përkatëse që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre në mënyrë që të mundësohen zgjedhje të drejta dhe një proces i mirëfilltë. Përmes një konference për medie zëdhënësja e shtabit zgjedhor, Doruntina Maloku, ka shprehur shqetësimet për

disa parregullsi dhe disa shkelje ligjore të cilat kanë ndodhur në disa vendvotime. "Ne bëjmë thirrje që të gjitha institucionet e zbatimit të ligjit t'i ushtrojnë kompetencat e tyre që të organizohet një proces ferr dhe demokratik në të cilin respektohen në përpikëri vullneti i qytetarëve", ka thënë Maloku. Po ashtu, pasdite Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) përmes një komunikate për media ka njoftuar se aktivistë të PDK-së kanë sulmuar fizikisht një arsimtar të Shkollës Filllore "Bislim Imeri" në Kçiq të Madh të Mitrovicës.

Ndërsa sekretari i përgjithshëm i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, është ankuar për disa parregullsi në procesin zgjedhor në Drenicë. Përmes një konference për medie, ai ka thënë se në disa fshatra të Skenderajt ka pasur presion ndaj qytetarëve që të votohet Partia Demokratike e Kosovës. "Ne si parti kemi një ankesë që është bërë nga shtabi ynë në Skenderaj se në këta fshatra ka persona të paautorizuar nëpër objekte shkollore, është lajmëruar në KKZ, nuk është se

## Ndalohen 20 persona lidhur me procesin zgjedhor

Koordinatorja Nacionale për Zgjedhje, Laura Pula, ka bërë me dije se gjatë procesit zgjedhor janë vërtetuar 16 raste për parregullsi me ç'rast janë ndaluar 20 persona. Ajo ka treguar se në rajonin e Prizrenit janë pesë raste me pesë persona, ku të gjithë janë të ndaluar për veprën penale "cenim i fshehtësisë së votimit". Kurse në rajonin e Pejës ka ndodhur një rast me dy persona të ndaluar për veprën penale "keqpërdorim i të drejtës së votimit". "Në rajonin e Gjakovës i kemi gjashtë raste kundër gjashtë personave, pesë persona janë të ndaluar dhe një person në kërkim, për veprat penale 'Pengimi i procesit të votimit' nga neni 214, 'Cenim i fshe-

htësisë së votimit' nga neni 215 dhe për veprën 'Asgjësimit i dokumenteve të votimit' nga neni 217. Në rajonin e Gjilanit kemi një rast me një person të ndaluar për veprën penale 'Parandalim i ushtrimit të së drejtës për të votuar' nga neni 209. Në rajonin e Mitrovicës i kemi dy raste me pesë persona të ndaluar, prej të cilëve dy për veprën penale 'Keqpërdorim i detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve' nga neni 211, si dhe tre për veprën penale 'Pengim i procesit të votimit' nga neni 214", ka thënë Pula. Kurse, sipas saj, në rajonin e Ferizajt është një rast me një person të ndaluar për veprën penale "Pengimi i procesit të votimit" nga neni 214.

vetëm ne po e bëjnë raportimin këtu. Thjesht, po informoj publikun për një ankesë që e kanë bërë njerëzit e shtabit të Nismës në Skenderaj, ku ka vërejtje se qendrat e votimit në Klloernicë, Runik, Prekaz i Ulët dhe i Epërm, Ticë, Açaevë, gjimnazi 'Hamëz Jashari', Abri e Poshtme, shkolla e mesme "Anton Çeta" Makërrmal, Izbicë. Pra, këtu sipas raportim-

it të shtabit tonë, del se votuesit janë duke u ndikuar nga një numër i madh personash të paautorizuar dhe janë duke bërë presion të votohet për Partinë Demokratike të Kosovës", ka thënë Sherif. Edhe koalicioni AAK-PSD gjatë ditës së diel ka mbajtur disa konferenca për medie, por nuk ka shprehur ndonjë ankesë specifike.





# Çka e pret qeverinë e ardhshme të Kosovës?

PRISHTINË, 6 TETOR - Dialogu dhe procesi i normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë pritet të jetë një nga sfidat kryesore edhe për qeverinë e ardhshme të Kosovës, e cila do të formohet si rezultat i zgjedhjeve parlamentare të 6 tetorit.

Ndërkaq në planin e brendshëm, qeverinë, sipas ekspertëve, e presin shumë sfida nga zhvillimi ekonomik deri tek ato të sundimit të rendit dhe ligjit.

Përfaqësues të shoqërisë civile dhe atyre të bizneseve adresojnë shumë prioritete të cilat duhet të jenë në tavolinën e qeverisë së ardhshme.

Normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, luftimi i korrupsionit, fuqizimi i rendit dhe ligjit si dhe liberalizimi i vizave janë vetëm disa prej çështjeve që, sipas tyre, duhet të adresohen nga qeveria e re.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian në vazhdimësi i kanë bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë për rifillim të dialogut pasi që, si i tillë, ka ngecur qëkur Kosova iu ka vënë taksë 100 për qind prodhimeve të importuara nga Serbia, në nëntor të vitit të kaluar.

Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ditë më parë zgjodhi ambasadorin amerikan në Gjermani, Richard Grenell, të dërguar të administratës së tij në dialogun midis Kosovës dhe Serbisë.

Demush Shasha nga Instituti i Kosovës për Politika Evropiane (EPIK), duke folur për "Radion Evropa e Lirë", thotë se dialogu

për normalizimin e marrëdhënieve midis Prishtinës dhe Beogradit është çështja kryesore për qeverinë e ardhshme. Sipas tij, dialogu për normalizimin e marrëdhënieve është parakusht i çdo procesi integruar. "Sa i përket procesit të integritimit evropian, gjëja e parë me të cilën do të duhej të merret qeveria e ardhshme është çështja e liberalizimit të vizave dhe në atë drejtim duhet të kthehet një klimë pozitive sa i përket normalizimit të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, edhe pse normalizimi i marrëdhënieve nuk është kriter zyrtar për liberalizimin e vizave, por është parakusht i çdo procesi integruar", ka thënë Shasha.

Detyra e dytë e qeverisë së ardhshme, shton Shasha, do të duhej të ishte marrja e hapave konkretë në luftën kundër korrupsionit në nivel të lartë dhe heqjes së ndikimit të politikës në sistemin e drejtësisë. "Këtë e them në kontekst të asaj që për tre vjetet e fundit Kosova nuk ka pasur asnjë rast të vetëm të profil-it të lartë sa i përket luftës kundër korrupsionit. Po ashtu, sa i preket procesit të përgjithshëm integruar, institucionet e ardhshme të Kosovës duhet ta vendosin theksin në zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit dhe agjendës evropiane të reformave, ku një numër i fushave presin progres të theksuar", është shprehur Shasha.

Përveç aspektit politik, një numër i madh i detyrave që presin Qeverinë e re janë ato në aspektin



ekonomik.

Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se prioriteti i parë i qeverisë së ardhshme duhet të jetë përmirësimi i sundimit të rendit e ligjit. Po ashtu, adresimi i boshllëkut të infrastrukturës transportuese dhe energjetike, sipas Zekës, duhet të jenë prioritetet e qeverisë së ardhshme. "Kur flasim për infrastrukturën transportuese duhet theksuar se ka pasur investime në

infrastrukturën rrugore, por ka ngecur mbrapa modernizimi i rrjetit hekurudhor dhe kjo është çfarë duhet të ndodhë në qeverinë e re, pra vazhdimi i investimeve në rrjetin hekurudhor që do ta lehtësonte operimin e shumë bizneseve si dhe të eksporteve.

Infrastruktura energjetike është e rëndësishme që, si e tillë, ta mundësojë diversifikimin e burimeve të energjisë, që të mos varemi vetëm nga konsumi i energjisë elektrike, por të shohim edhe burime të tjera, pse

jo edhe të kyçjes së Kosovës në rrjetet ndërkombëtare të furnizimit me gaz", ka thënë Zeka.

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë u mbajtën më 6 tetor. Nga procesi i votimit pritet të zgjidhet përbërja e re e Kuvendit të Kosovës, nga e cila më pas, partia apo koalicioni fitues do ta marrë mandatin për formimin e qeverisë së ardhshme të Kosovës.

Brenda 100 ditëve të para të qeverisë, shton Zeka, do të duhej të hartohej një strategji nacionale e zhvillimit ekonomik e cila do të ishte udhërrëfyese për reformat që duhen bërë për zhvillimin e gjithëmbarshtëm ekonomik.

"Prioritetet të cilat duhet të ushqejnë këtë strategji duhet të jenë ato që lidhen me fuqizimin e sundimit të rendit dhe ligjit, të shohim një efikasitet më të madh jo vetëm në trajtimin e kontesteve të natyrës komerciale që kanë qenë shqetësim i bizneseve, por edhe zbatimin e mirëfillt të ligjeve. Kur flasim për fuqizimin e sundimit të rendit dhe ligjit duhet të shihen rezultatet konkrete në luftimin e të gjitha formave të korrupsionit", ka theksuar Zeka.

Vëmendje e rëndësishme nga qeveria e re, shton Zeka, duhet kushtuar zhvillimit të kapitalit njerëzor, duke filluar nga reformimi i sistemit të edukimit në të gjitha nivelet e tij, me qëllim të nxitjes së ndërmarrësisë në mesin e gjeneratave të ardhshme, por edhe përmirësimin e raportit ndërmjet kërkesës dhe ofertës në tregun e punës.

## QKUK-ja përmes investimeve synon ta kthejë besimin te pacientët

PRISHTINË, 6 TETOR - Ndonëse vetëm gjatë këtij viti në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) janë investuar rreth pesë milionë euro, pacientët thonë se gjendja brenda klinikave nuk është e mirë.

Drejtori i Qendrës Klinike Universitare, Basri Sejdiu, thotë për "Rel" se qëllimi ishte që investimet të përfshihen në 16 klinika, te të cilat është paraqitur nevoja që të intervenohet qoftë në aparaturë apo edhe infrastrukturë. Ai ka theksuar se këto investime kanë qenë projekte të mëhershme, por janë finalizuar këtë vit. "Investimet gjatë këtij viti në shëndetësi kanë qenë vazhdimësi edhe e vitit të kaluar dhe mund të them se gati të gjitha klinikat janë prekur nga investimet. Emergjencia është rinovuar tërësisht, është bërë krijimi i infrastrukturës moderne, pastaj Kardiologjia Invazive me



Kardiokirurgji. Po ashtu, kemi investuar në reumatologji, në ambulancat specialistike, duke e bërë digjitalizimin e tyre. Gjithashtu, Klinika Neurologjike është pajisur me CT dhe renovim

komplet. Ndërsa në klinikën në të cilën fare nuk ka pasur hapësira, është fjala për alergologjinë, ku kanë qenë të punësuar 13 mjekë dhe një infermier, ka punuar me vetëm një dhomë dhe janë bërë

vetëm vizita ambulatore. Tash aty pacientët mund të hospitalizohen, pra është krijuar hapësira sipas standardeve evropiane", ka thënë Sejdiu. Ai ka pohuar se investimet nëpër klinika janë në

proces. Ai përmend edhe disa investime të tjera, të cilat, sipas tij, pritet të përfundojnë së shpejti. "Është në procedurë komplet renovimi i Klinikës së Radiologjisë, i Biokimisë, ndërtimi i sallave të Kirurgjisë Plastike. Po ashtu, janë duke u rinovuar ambulancat specialistike së bashku me Klinikën e Oftalmologjisë dhe të ORL-së si dhe Klinikën e Logopedisë. Edhe shumë klinika të tjera. Qëllimi është që pacientët të kenë qasje më të lehtë dhe trajtim më profesional dhe cilësor. Por, qëllimi kryesor është që t'u kthehet besimi qytetarëve në institucione shëndetësore publike për shkak që ata të mos paguajnë shumën të mëdha për trajtime", ka deklaruar Sejdiu.

Qendra Klinike Universitare e Kosovës është e vetmja qendër terciare referente për tërë Kosovën.



# Bieber: Perspektivat e reja varen nga krijimi i koalicioneve në Kosovë



Eksperti i Ballkanit, Florian Bieber, profesor i politikës dhe historisë së Evropës Juglindore në Universitetin e Grazit dhe drejtues i Qendrës Studimore për Studimet e Evropës Juglindore të Universitetit të Grazit, ka folur për zgjedhjet parlamentare të 6 tetorit në Kosovë, shanset e dialogut me një qeveri të re të Kosovës dhe shenjat se BE-ja do të emërojë një të dërguar të posaçëm për dialogun Kosovë - Serbi në të ardhmen

PRISHTINË, 6 TETOR -

"Deutsche Welle": Më 6 tetor Kosova votoi për parlamentin e ri. Si mendoni, do ta nxjerrin këto zgjedhje Kosovën nga stacioni?  
**Florian Bieber:** Natyrisht i shoh si të rëndësishme këto zgjedhje, ato po zhvillohen para kohe, por ndoshta janë zgjedhje që nuk do ta nxjerrin qartë në pah një drejtim të caktuar, se në radhë të parë bëhet fjalë për orientimin e brendshëm politik në Kosovë në të ardhmen, në kuptimin se sa do të jetë në gjendje të dominojë edhe më tej PDK-ja, partia që ka qenë që para pavarësisë dominante në Kosovë. Kjo është çështja që vendosin këto zgjedhje, ndërsa lidhur me temën e dialogut, Kosovë-Serbi, zgjedhjet ndoshta hapin perspektiva të reja, por nuk shoh ndonjë ndryshim të madh kursit. Nëse kjo bëhet, atëherë më shumë si rezultat i krijimit të koalicioneve, se sa nga vetë zgjedhjet.

"Deutsche Welle": Doganat 100 për qind me Serbinë mbetën në fuqi, me gjithë thirrjet e BE-së, Qeveria e Kosovës kërkon që Serbia t'i ndalë fushatat kundër shtetit të Kosovës, për heqjen e tyre. Çfarë ndryshimi mund të sjellin zgjedhjet në këtë drejtim?  
**Florian Bieber:** Mendoj se mund të priten lëvizje në këtë drejtim, sepse jo të gjithë partitë angazhohen në të njëjtën masë për ruajtjen e doganave. Tani bëhet fjalë më shumë, se çfarë zgjidhje mund të gjendet, që qeveria e re të jetë në gjendje ta pezullojë vendosjen e doganave, pa e pranuar si humbje apo dështim këtë. Kjo do të varet shumë edhe nga ajo, se si BE-ja e re do të iniciojë dialogun. Mendoj, se BE duhet të dërgojë një sinjal të qartë dhe të thotë; ne kemi nevojë

në fillim për masa që mundësojnë krijimin e besimit mes Kosovës dhe Serbisë.

"Deutsche Welle": Por a nuk duket se pikërisht BE-ja ka arritur limitet e saj të ndërmjetësimit pasi dialogu ka kohë që ka ngrirë?

**Florian Bieber:** Po, vërtet, dialogu në këtë format siç ishte ka arritur në limitet e tij. Mënyra dhe ashtu si u zhvillua dialogu nuk ishte produktive, edhe ajo që e drejtoi dialogun nuk ishte produktive, Federica Mogherini në fund nuk ishte në gjendje ta drejtonte dialogun. Natyrisht që kjo nuk varet vetëm nga BE, por edhe nga dy aktorët pjesëmarrës. Si Qeveria e Kosovës edhe ajo e Serbisë, mendoj se nuk kishin qëllim vërtet serioz për zhvillimin e dialogut. Këtë nuk mund ta zgjidhë me shkop magjik BE, por ajo mund të krijojë parametrat e të thotë, një dialog ka nevojë për vullnet të mirë dhe ka nevojë për gjeste çtensionimi.

"Deutsche Welle": Thatë se ky format i dialogut ka arritur limitet e tij. Cili do të ishte formati i përshtatshëm?

**Florian Bieber:** Një format i ri do të thotë takime më intensive, punë më intensive për një marrëveshje gjithëpërfshirëse, jo takime sporadike si në të shkuarën. Por edhe vendosjen e qartë të vijave të kuqe, që do të thotë përjashtimin e vendosjes së kufijve të rinj, kjo është e rëndësishme. Tjetra kemi nevojë për ngritjen e besimit, që do të thotë të ndalen provokimet e konflikteve si nga pala serbe edhe kosovare, siç i kemi parë në të shkuarën, këtu BE duhet të përdorë pushtetin e saj. Për shembull të thotë, janë të papranueshme bllokimet që i bëri Serbia anë-

tarësimit të Kosovës në Interpol apo në UNESCO.

"Deutsche Welle": Vuçiqi ka thënë disa herë se Serbia nuk mund të humbasë gjithçka dhe Kosova t'i fitojë të gjitha. Si mendoni ju, çfarë do ta sillte atë deri aty sa të thoshte ndoshta fjalën më të famshme të shekullit për Ballkanin, e pranojmë shtetin e Kosovës, ndoshta jo njohje, por e pranojmë si realitet, i cili do të ishte ky "deal", kujtojmë, se viti 2018 ishte nën shenjë e ndryshimit të kufijve...

**Florian Bieber:** Problemi është mendoj, se Vuçiqi nuk është në gjendje dhe nuk e do vërtet një marrëveshje, sepse ai vetë në Serbi qeveris në mënyrë jodemokratike. Ai e sheh dialogun si legjitimim të tij në rrafshin ndërkombëtar, e mendoj, se ai nuk është vërtet aq i interesuar për të. Për ta thënë këtë fjali, pra që e pranojmë pavarësinë e Kosovës, ai duhet të përgatiste në fillim popullin në Serbi për një hap të tillë. Por në vitet e fundit ne shohim vetëm, se është forcuar rëndësia e Kosovës për popullsinë serbe, që do të thotë, se më shumë njerëz se para 5-6 vjetësh e shohin Kosovën si një temë të rëndësishme. E kjo është pasojë e retorikës së mediave, që janë të afërta me Vuçiqin. Pra, duket se ai nuk po e përgatit popullin e tij për një kompromis, por po e nxit më shumë në drejtimin e kundërt.

"Deutsche Welle": Mendoni se tema e ndryshimit të kufijve përfundimisht i përket së shkuarës?

**Florian Bieber:** Derisa të ketë ardhur puna tek një zgjidhje apo një zgjidhje tjetër nuk mund ta përjashtosh, se mund të rishfaqet si temë. Mendoj, se ideja e këmbimit të territoreve jeton në përfytyrimin

e shumë vetëve, sidomos në Serbi. E shoh si propozim negativ dhe jorealit, sepse nuk besoj që një gjë e tillë do të pranohej nga pala kosovare në një dialog serioz, kur është e qartë, se cilat janë alternativat e kësaj.

"Deutsche Welle": Si i shikoni shanset për iniciativa të reja me një ekip të ri të BE-së? Mendoni se do të jetë problem që i ngarkuari i ri i BE-së, Joseph Borrell, vjen nga një vend që nuk e njeh Kosovën? A mundet që një i dërguar i posaçëm ta kompensojë këtë?

**Florian Bieber:** Deri tani kam përshtypjen, se Borrell shumë pak është marrë seriozisht me këtë çështje. Mendoj se është i rëndësishëm një i dërguar i posaçëm i BE-së për dialogun dhe ka shenja se do të emërohet një i dërguar i tillë. Pyetja kryesore, është se kush do të jetë i ngarkuari apo e ngarkuara e posaçme për dialogun, pra me çfarë profili, me çfarë rëndësie, sepse ky i ngarkuar do të jetë në fund ai ose ajo që do të gjejë një format të ri e duhet t'i japë peshë atij. Për Borrell është e rëndësishme që ai ta mbështesë këtë, po ashtu edhe eurokomisioneri i zgjerimit. Ka ende gjëra të panjohura, dhe ende nuk kemi parë që BE ka një strategji për këtë, sigurisht është shumë herët.

"Deutsche Welle": Shumë njerëz në Kosovë besojnë se gjërat lëvizin vetëm me dorën amerikane...

**Florian Bieber:** Sigurisht është e qartë, që një dialog i suksesshëm, funksionon në fund të fundit, nëse Shtetet e Bashkuara janë në anën e

BE, ndryshe ka rrezik të madh, që të dyja palët të përpiqen t'i vënë kundër njëra-tjetrës BE e SHBA apo vetë vendet anëtare të BE. Këtë e përjetuam tek tema e ndryshimit të kufijve, ku të dyja palët u përpoqën të vinin kundër njëra-tjetrës shtetet anëtare dhe BE kundër SHBA.

"Deutsche Welle": Kosovarët presin liberalizimin e vizave, rinia ndihet e izoluar, zhgënjimi është i madh, një satirë thotë se liberalizimin do ta marrim në vitin 2076. A mund të kthehet ky zhgënjim në ushqim për radikalizime të tipit nacionalist?

**Florian Bieber:** Për fat të keq në Bashkimin Evropian fryn tani një erë me drejtim të kundërt me atë që duhet për të ndërmarrë hapa për të integruar më shumë vendet e Ballkanit Perëndimor, dhe kjo përfshin edhe lirinë e lëvizjes pa viza. Për mua ky është një gabim i madh i Bashkimit Evropian, që nuk ishte në gjendje ta miratonte liberalizimin e vizave. Por duket shumë e vështirë për BE-në ta arrijë një politikë të tillë sepse disa vende janë qartësisht kundër. Nuk varet vetëm nga Kosova, por nga ana tjetër një qeveri e stabilizuar e serioze mund t'i reklamojë më mirë mesazhet e saj. Natyrisht sa më e gjatë të mbahet e bllokuar Kosova, qoftë për dialogun, qoftë për mosnjohjen, aq më shumë njerëzit do të shikojnë të gjejnë alternativa të tjera, e shpesh këto alternativa janë nacionaliste. Gjendja e status-quo çon drejt një dinamike negative të zhvillimeve.





Flet për "Epokën e re", Ardian Syla

# Partneriteti publiko-privat, forma më e



Kryesuesi i Bordit të "Trepçës", Ardian Syla, ka thënë se pa investime të huaja rimëkëmbja e "Trepçës" do të ishte shumë më e ngadalshme dhe thuajse e paarrtshme. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se partneriteti publiko-privat si formë e investimit do të ishte forma më e përshtatshme e kësaj kohe deri në fuqizimin e ndërmarrjes "Trepça". Ndërkaq sa i përket konkursit të fundit për punësim në "Trepçë", konkurs ky që u cilësua për poenë politike, Syla ka thënë shtimi i numrit të punëtorëve është i domosdoshëm

në ndërmarrje dhe do të ishte më lehtë të kontrollohet investimi dhe kahet e drejtimit të "Trepçës", ka thënë ai. Sa i përket konkursit të fundit për punësim në "Trepçë", konkurs ky që u cilësua për poenë politike, Syla ka thënë se shtimi i numrit të punëtorëve është i domosdoshëm. "E kuptoj një gjuhë të tillë, sidomos kur ishte në fushatë zgjedhore. Gjithsesi, ju njoftoj dhe garantoj që menaxhmenti i 'Trepça Sh. A' këtë konkurs e ka hapur për të sjellë fuqi të re punëto-re, e cila do të ndikonte në performancë më të mirë të ndërmarrjes. Më lejoni të theksoj, me aq sa na është bërë e ditur neve si bord mbikëqyrës, nga ana e menaxhmentit, një numër i konsiderueshëm nga punëtorët aktualë këtë vit do të dalin në pension andaj, pos të tjerash, konkursi është në funksion të plotësimit të atyre vendeve dhe ripërtëritjes së moshës mesatare", ka thënë Syla.

"Trepça Sh. A." nuk është e kënaqshme dhe vazhdimisht jemi duke u ballafaquar me mungesë të prodhimit, i cili po shkakton vonesë në paga dhe kryerje të obligimeve të tjera siç janë shpenzimet operative. Pa dyshim kjo mungesë e prodhimit është e ndikuar edhe nga teknologjia e vjetruar dhe mungesat e investimeve në këtë drejtim për vite me radhë. Si rrjedhojë e tërë kësaj, binomi i fuqisë punëto-re dhe teknologjisë adekuate do të rezultonte me prodhim më të mirë dhe me rimëkëmbje më të shpejtë të "Trepçës".

**"Epoka e re":** Megjithëkëtë keni deklaruar se prisni që trendi i rritjes së prodhimit të vazhdojë dhe se me fuqinë e re punëto-re do të stabilizohet prodhimi. A po ndodh kjo?

**Syla:** Patjetër. Trendi i rritjes së prodhimit veçse ka filluar të ngrehet në muajt e fundit, edhe pse jemi larg prej asaj që është e pritshme nga ana jonë. Siç e ceka më lart, një bashkim forcash mes fuqisë së re punëto-re dhe investimeve në teknologji, ky trend veçse do të

**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 6 TETOR** - Kryesuesi i Bordit të "Trepçës", Ardian Syla, ka thënë se gjendja aktuale në "Trepçë" nuk është e kënaqshme dhe se vazhdimisht janë duke u përballur me mungesë të prodhimit, gjë e cila edhe po shkakton vonesën në paga dhe kryerjen e obligimeve të tjera siç janë shpenzimet operative. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Syla ka thënë se trendi i rritjes së prodhimit veçse ka filluar të ngrehet në muajt e fundit. "Trendi i rrit-

jes së prodhimit veçse ka filluar të ngrehe në muajt e fundit, edhe pse larg jemi prej asaj që është e pritshme nga ana jonë. Siç e ceka më lart, një bashkim forcash mes fuqisë së re punëto-re dhe investimeve në teknologji, ky trend veçse do të jetë edhe më i lartë. Fuqia e re punëto-re dukshëm do ta ndryshojë trendin e prodhimit për të mirë, përkundër teknologjisë së vjetruar", është shprehur ai. Syla ka thënë se pa investime të huaja rimëkëmbja e "Trepçës" do të ishte shumë më e ngadalshme dhe thuajse e paarrtshme. Sipas tij, partneriteti publiko-

privat do të ishte forma më e përshtatshme e investimit në këtë kohë deri në fuqizimin e ndërmarrjes "Trepça" pasi, sipas tij, do të ruhej ndikimi i qeverisë në këtë ndërmarrje dhe do të ishte më lehtë që të kontrollohet investimi dhe kahet e drejtimit të "Trepçës". "Pa investime të huaja rimëkëmbja e 'Trepçës' do të ishte shumë më e ngadalshme dhe thuajse e paarrtshme. Mbase partneriteti publiko-privat si formë e investimit do të ishte forma më e përshtatshme e kësaj kohe deri në fuqizimin e ndërmarrjes sepse do të ruhej ndikimi i qeverisë

**"Epoka e re":** Z. Syla, cila është gjendja e ndërmarrjes "Trepça"?

**Syla:** Gjendja aktuale në



# përshtatshme për investime në 'Trepçë'



direkte private, investimet e përbashkëta dhe emetimi dhe shitja e aksioneve. Që të katër këto forma janë të përshtatshme dhe do të ishin një lëvizje e madhe drejt ngritjes së "Trepçës" dhe bërjes së saj një

konkurrente në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar dhe një kontribuues në GDP-në e vendit. Mbase partneriteti publiko-privat si formë e investimit do të ishte forma më e përshtatshme e kësaj kohe deri

në fuqizimin e ndërmarrjes, sepse do të ruhej ndikimi i qeverisë në ndërmarrje dhe do të ishte më lehtë që të kontrollohet investimi dhe kahet e drejtimit të "Trepçës".

## 300 qytetarë pritet ta marrin lejen e legalizimit në Durrës, Kavajë e Peshkopi

**DURRËS, 6 TETOR** - Agjencia e Kadastrës në Shqipëri ka publikuar listën e 300 personave që kanë gati lejet e legalizimit në Durrës, Kavajë e Peshkopi. Përfituesit duhet ta tërheqin lejen e legalizimit dhe më pas presin që Agjencia e Kadastrës ta ndjekë procedurën për pajisjen e tyre me certifikatën e pronësisë. Procedurat për marrjen e tapisë janë ndjekur nga Agjencia e Kadastrës, e cila dorëzon dosjen e plotë në hipotekë, por përfituesit duhet të shkojnë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të aplikojnë për tapinë. Pas ndryshimeve të fundit ligjore, qytetari do të marrë një kopje për ta vërtetuar mbarimin e procesit të legal-

izimit, por e gjithë procedura vijuese për regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të bëhet nga Agjencia.

Sipërfaqja e parcelës për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për ndërtimet pa leje me funksion banimi jo më shumë se 500 metra katrorë.

Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të cilat për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar

me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin nëpërmjet një kërkesë me shkrim.

Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve; në pjesë takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirisht dhe të depozituara brenda afatit të vetëdeklarimit. Subjektet mund të përcaktojnë, përveç pjesës takuese, edhe pjesët fizike respektive, nëse ndërmjet tyre përputhet vullneti.

jetë edhe më i lartë. Fuqia e re punëtore dukshëm do ta ndryshojë trendin e prodhimit për të mirë përkundër teknologjisë së vjetruar.

**"Epoka e re":** Kishte zëra se konkursi i fundit ishte për poenë politike. A qëndron kjo?

**Syla:** E kuptoj një gjuhë të tillë, sidomos kur ishte në fushatë zgjedhore. Gjithsesi, unë ju njoftoj dhe garantoj që menaxhmenti i 'Trepça Sh. A.' këtë konkurs e ka hapur për të sjellë fuqi të re punëtore, e cila do të ndikonte në performancë më të mirë të ndërmarrjes. Më lejoni të theksoj, me aq sa na është bërë me dije neve si bord mbikëqyrës nga ana e menaxhmentit, një numër i konsiderueshëm nga punëtorët aktualë këtë vit do të dalin në pension andaj, pos të tjerash, konkursi është në funksion të plotësimit të atyre vendeve dhe ripërtëritjes së moshës mesatare. Gjithsesi, konkursi është shpallur nga ana e menaxhmentit dhe jo nga bordi mbikëqyrës.

**"Epoka e re":** Pa investime të

huaja a mund të flitet për rimëkëmbje të "Trepçës", pasi 80 për qind të aksioneve i zotëron Qeveria e Kosovës?

**Syla:** Pjesëmarrja e qeverisë si aksionare, me pronar të 80 për qind të aksioneve, e ka të pashmangshme rrugën e investimeve kapitale në "Trepça Sh. A." për ta rimëkëmbur atë. Prandaj i takon Qeverisë së Republikës së Kosovës që në bashkëpunim me bordin e "Trepça Sh. A." ta gjejnë formën adekuate të investimeve, gjithmonë brenda kufijve të lejueshëm që përcakton Ligji për "Trepçën" dhe statuti i saj. Pa investime të huaja rimëkëmbja e "Trepçës" do të ishte shumë më e ngadalshme dhe thuajse e paarrtshme.

**"Epoka e re":** Në Ligjin për "Trepçën" kemi disa mënyra të investimeve apo dhe mundësi të privatizimit apo shitjes së një pjese të aksioneve. Cila është rruga ideale që "Trepça" do të kontribuonte në GDP të vendit?

**Syla:** Është ligji që përcakton katër forma kryesore të investimeve: Partneriteti publiko-privat, investimet





## Përfundon punimet forumi rinor ndërkombëtar për punësim në Gjakovë

GJAKOVË, 6 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka bërë përmbylljen zyrtare të Forumit Rinor Ndërkombëtar për Punësim të Gjellbër në Ballkan, i cili është mbajtur në këtë komunë për tri ditë me radhë. Me këtë rast, të rinj nga Evropa Qendrore dhe Lindore, përfshirë ata nga

Kosova dhe Shqipëria, janë certifikuar për pjesëmarrjen e tyre në këtë ngjarje.

Gjini është shprehur i lumtur për organizimin e këtij forumi në komunën që ai drejton. "Jam shumë i lumtur që ky forum është mbajtur në Gjakovë. Shpresoj që keni kaluar mirë dhe që një ditë të ktheheni këtu me përvoja të

tjera", ka thënë kryetari Gjini para të rinjve dhe të gjithë organizatorëve.

Qëllimi i gjithë forumit frankofon ishte që të rinjtë të sjellin ide dhe projekte të reja që stimulojnë rritje dhe zhvillim në aspektin ekonomik dhe social, duke reduktuar efektet e dëmshme mbi mjedis.



## Shënohet 'Dita e Gështenjës' në Deçan

Deçan, 6 tetor (ER) - Një manifestim kulturor e me motive tradicionale është mbajtur në Deçan, duke shënuar kështu "Ditën e Gështenjës". Në këtë manifestim janë ekspozuar piktura të ndryshme dhe është mbajtur një orë letrare me qëllim të promovimit të vlerave tradicionale dhe gështenjës.

Ngjarja në fjalë është organizuar nga "Iniciativa për Zhvillim" dhe është mbështetur nga Ministria e Kulturës dhe Komuna e Deçanit. Deçani njihet për hapësira me gështenja, të cilat në shumë raste edhe sigurojnë jetesën e banorëve të fshatit Belle dhe fshatrave të tjerë përreth.

Kryetari i Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka thënë se për të gështenjat kanë rëndësi të veçantë pasi, sipas tij, ato kanë mundësuar shkollimin dhe veshmbathjen e tij dikur. "Në një periudhë kohore kur unë kam qenë student, gjendja ekonomike në këtë vend dhe gjithë ne studentët e asaj kohe edhe baballarët tanë përpara dhe gjeneratat më të vjetra se unë, mbijetesën e kanë bërë me gështenja. Përveç me gjëra të tjera, bujqësi e blegtori, gështen-



ja ka qenë një produkt i dhuruar prej Zotit që neve na ka mundësuar të shkollohemi, na ka mundësuar t'i blejmë teshat, këpucët, ta paguajmë semestrin, banesat", ka thënë Ramosaj.

Ai ka thënë se edhe gjyshet e tyre edhe stërgjyshërit e kanë pasur

një produkt të sigurt gjatë ecjes së tyre në këtë jetë. "Për atë është një tendencë e drejtë që ne ta respektojmë këtë ditë, këtë produkt që e kemi dhuratë prej Zotit", është shprehur Ramosaj. Ndërsa Ajne Iberhysaj nga "Iniciativa për zhvillim" ka thënë

se këtë manifestim synojnë ta bëjnë tradicional, i cili për herë të parë është mbajtur në fshatin Belle. "Të promovohen vlerat tradicionale, turizmi lokal dhe vlerat natyrore të fshatit Belle. T'i marrë ky fshat emërtimet, përveç atyre që i ka, historike dhe

kulturore, edhe atë poetike", ka thënë ajo.

Pjesë e manifestimit ishin artistë nga Deçani, nga vende të tjera të Kosovës, madje edhe të diasporës.

Komuna e Deçanit ka për sipërfaqe të madhe të gështenjave.



## Familja shtatanëtarëshe nga Kopiliqi i Poshtëm do të bëhet me shtëpi

SKENDERAJ, 6 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, së bashku me humanistin Halil Kastrati, kanë vizituar familjen e Ramiz Sahitit nga fshati Kopiliqi i Poshtëm i kësaj komune, ku i kanë kumtuar lajmin kësaj familje se do të bëhet me shtëpi. Me këtë rast, Jashari ka theksuar se kjo familje është duke jetuar në kushte të vështira ekonomike. "Sot, së bashku me human-

istin Halil Kastrati, i kumtuam lajmin kësaj familje shtatanëtarëshe, se çështja e strehimit për të po zgjidhet falë një donatori të komunës tonë, që ka shprehur vullnetin ta financojë ndërtimin e kësaj shtëpie përmes shoqatës bamirëse 'Jetimat e Ballkanit'. Faleminderit të gjithë bamirësve për kontributin e tyre!", ka shkruar Jashari në llogarinë e vet në "Facebook".

## Prizreni, pjesë e forumit në Slloveni mbi të ardhmen e qyteteve

PRIZREN, 6 TETOR (ER) - Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Levent Kasëmi, po merr pjesë në konferencën ndërkombëtare Forumi i Lubjanës në

Slloveni mbi të "Ardhmen e qyteteve". Në kuadër të këtij forumi, ku pjesëmarrës janë përfaqësues nga qytete të ndryshme të Evropës Juglindore, po nda-

hen njohuritë dhe përvojat e qeverisjes si dhe po përcaktohen fushat kryesore, vizionet dhe strategjitë e ardhshme të zhvillimit të qyteteve. Këtë vit kur po

mbahet edicioni i nëntë i këtij forumi, vëmendje të veçantë po u kushtohet projekteve infrastrukturore dhe transformimit digjital.





# Kush përfiton nga procedura e shkarkimit të Trumpit?



**Janusz BUGAJSKI**

Me përshpejtimin e hetimeve për shkarkimin e presidentit Donald Trump në Kongres, politikanë të ndryshëm mund të përfitojnë ose mund të humbin nga kriza. Më shumë se kushdo, pretendentët demokratë për president do të garojnë për çdo avantazh, ndërsa Trumpi dhe aleatët e tij republikanë do ta vënë në provë unitetin dhe popullaritetin e demokratëve. Javët e ardhshme mund të rezultojnë vendimtare në garën për nominimin (kandidatin) e demokratëve që do të sfidojë Trumpin në zgjedhjet e nëntorit 2020, duke supozuar se ai do të jetë deri atëherë në detyrë. Skandali që shkaktoi hetimin zyrtar për shkarkim ishte një përpjekje e Trumpit për ta shkualifikuar (kandidatin) kryesues mes demokratëve, Joe Biden, sipas akuzave, duke i bërë presion qeverisë së Ukrainës për ta hetuar atë. Në të gjitha sondazhet e opinionit publik, Trump ndjek Bidenin me diferencë të konsiderueshme, veçanërisht në shtetet 'e lëkundura' të cilat duhet t'i fitojë për të mbetur si president. Trumpi dhe shumë liderë republikanë janë të vendosur ta shndërrojnë procesin e hetimit për shkarkimin e tij në një 'mjet'

me të cilin ta sulmojnë Bidenin. Ata po përdorin mediat konservatore për të përhapur akuza që janë konsideruar nga ekspertët si teori konspirative pa vlerë. Akuza kryesore, sipas së cilës Bideni kërkoi t'i mbyllte hetimet mbi lidhjet korruptive të biznesit të djalit të tij në Ukrainë, tashmë është hedhur poshtë. Por, ashtu si me sulmet ndaj Hilary Clintonit gjatë vitit 2016, shumë histori do të amplifikohen gjerësisht për t'u dhënë energji mbështetësve kryesorë të Trumpit. Çështja është se cilët demokratë do të mundohen të përfitojnë nëse Trumpi vazhdon ta sulmojë Bidenin gjatë gjithë fushatës. Edhe pse shumica e demokratëve e mbështesin Bidenin në 'betejën' e tij me Trumpin, shumë janë të shqetësuar se ai mund të dobësohet ndjeshëm në sytë e publikut, ashtu si Hilary Clintoni pas akuzave pafund të Trumpit dhe zbulimeve në media. Jo të gjithë demokratët do ta mbrojnë Bidenin nga sulmet e republikanëve, pasi ata nuk

duan që zemërimi i publikut ndaj Trumpit të kanalizohet në mbështetje të plotë të emërimit të Bidenit (si kandidati demokrat). Për momentin, kandidatja e vetëshpallur "progresiste", senatorja Elizabeth Warren, duket e vendosur të përfitojë nga kjo. Mbështetja për të midis demokratëve është rritur javët e fundit, madje ka eklipsuar zërin kryesor "progresiv" në zgjedhjet e fundit, senatorin Bernie Sanders. Sidoqoftë, Warren ka pak mbështetje midis republikanëve, të pavarur dhe votuesve të lëkundur, të cilët do t'i duhen në nëntor të 2020-s, nëse dëshiron të jetë gruaja e parë presidente. Edhe pse fushata do të vazhdojë edhe për më shumë se një vit, mundësia e Warrenit për t'u zgjedhur mbetet ende e diskutueshme. Vetë Joe Biden mund të fitonte më shumë votues nëse ai do të bëhet më agresiv në ndjekjen e Trumpit në vend që thjesht të mbrohet kundër akuzave të korrupsionit. Në të vërtetë, nuk do të ishte shumë e vështirë që

'shigjetat' të ktheheshin kundër Trumpit kur merren parasysh raportimet e shumta për marrëveshje biznese të errëta nga praktikisht të gjithë anëtarët e familjes së tij. Bideni, gjithashtu, mund të përfitojë nga procesi i hetimit për shkarkim, duke marrë mbështetje për Kushtetutën amerikane dhe për t'i dhënë fund ndërhyrjes së huaj në zgjedhje, të cilën Trumpi e ka mbështetur hapur. Si një demokrat i qendrës, Bideni ka më shumë gjasa t'i bëjë për vete republikanët e moderuar dhe të pavarurit. Për më tepër, ai ka një të kaluar mbresëlënëse në kongres, qoftë në politikën e jashtme ashtu edhe në atë të brendshme. Vetë Trumpi ka ndërmarrë një 'risk', duke u përqendruar vetëm te Bideni, pasi shumë votues do të arrijnë në përfundimin se ish-zëvendëspresidenti është, në fakt, kandidati më i besueshëm për ta hequr Trumpin. Ajo që e penalizon më shumë Bidenin është mosha e tij, bazuar në perceptimin se ai nuk është aq energjik sa ishte kur shërbente

në senat dhe Shtëpinë e Bardhë. Edhe pse Trumpi është vetëm tre vjet më i ri se Bideni, ai shpesh duket se është (fizikisht) më i fuqishëm. Pasi kanë nisur hetimin zyrtar, demokratët do të jenë në ankth gjatë muajve në vazhdim. Në të vërtetë, Trumpi mund të fajësohet në Dhomën (e Përfaqësuesve), por të mos shkarkohet nga detyra në Senat. Një përfundim i tillë mund të shihet si një humbje thelbësore politike që mund ta penalizonte kandidatin demokrat në zgjedhjet e vitit 2020. Kjo mund t'i dekurajojë shumë demokratë nga votimi, ndërsa do t'i inkurajonte mbështetësit e Trumpit. Trumpi sigurisht se do të përfitonte nga një pjesëmarrje e ulët në votime.

Shumë gjëra varen nga zbulimet e sakta gjatë hetimit zyrtar për shkarkim dhe nga (mënyra) se si do të reagojnë republikanët e (rangut të) lartë. Republikanët kanë një shumicë (me një diferencë) të ngushtë në Senat dhe në nëntor të vitit 2020, 23 prej tyre do të përballen me rizgjedhje. Disa strategjistë republikanë besojnë se nëse vota e Senatit për shkarkim do të ishte e fshehtë, të paktën tridhjetë republikanë do të votonin për ta hequr Trumpin nga detyra dhe kështu shumica e nevojshme e dy të tretës (2/3) do të arrihej lehtësisht. Por, meqë votimi nuk do të jetë i fshehtë, do të duhet një ndryshim edhe më i madh në opinionin publik që ata t'i bashkojnë votat me demokratët.

(Marrë nga gazeta Dita, Shqipëri)



## Filloi ndërtimi i kolektorit kryesor të ujërave të zeza

**PODUJEVË, 6 TETOR (ER)** - Kanë nisur punimet për ndërtimin e kolektorit kryesor për grumbullimin e ujërave të zeza në Podujevë, projekt ky që po realizohet përmes kredisë së butë, përmes klauzolës për investime, sipas marrëveshjes për bashkëpunim financiar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë. Në ceremoninë solemne të fillimit të punimeve, në Lluzhan, ishin të pranishëm kryetari i Komunës së Podujevës, Agim Veliu dhe Christoph Gierlinger, drejtor i kompanisë austriake OSTAP, e cila është mbikëqyrëse e realizimit të projektit, të hartuar nga kjo kompani. Kryetari Veliu me këtë rast ka thënë se po fillon realizimi i pro-

jektit më të rëndësishëm për mbrojtjen e ambientit. "Bashkë me drejtorin e kompanisë austriake OSTAP, Christoph Gierlinger, solemnisht filluam punimet për ndërtimin e kolektorit kryesor për grumbullimin e ujërave të zeza. Ky është projekti më i madh dhe më i rëndësishëm për mbrojtjen e ambientit që po realizohet në Komunën e Podujevës. Me realizimin e këtij projekti lumenjtë do të mbrohen nga ujërat e zeza, ndërsa projekti tjetër i radhës do të jetë ndërtimi i një impiantifabrike për përpunimin e këtyre ujërave të zeza", ka thënë Veliu. Projekti për ndërtimin e kolektorit kryesor të ujërave të zeza në Komunën e Podujevës, në vlerë prej 5.3 milionë eurosh, realizohet përmes Soft Loan



kredi, kurse implementimi investime, sipas marrëveshjes mes të Qeverisë së Kosovës dhe bëhet përmes klauzolës për bashkëpunim financiar në Qeverisë së Austrisë.



## Vazhdojnë protestat në Hong Kong

**HONG KONG, 6 TETOR** - Policia e Hong Kongut përdori gaz lot-sjellës në disa zona të dielën ndërsa dhjetëra-mijëra protestues pro-demokracisë dolën në rrugë, duke kundërshtuar ndalimin e maskave të fytyrës.

Protestuesit mund të shiheshin duke përshtuar qytetin me ombrella ndërsa shiu binte mbi ta.

Qeveria e Hong Kongut të premten i ndaloi njerëzit të mbanin maska në protestat publike duke cituar një nen të epokës koloniale britanike për emergjencat që është përdorur për herë të fundit për të shuar trazirat në vitin 1967.

Protestuesit, përfshi disa me maska, marshuan nëpër qytet pas vendimit, duke çuar në mitingje, si dhe përleshje të dhunshme.

Ligjvënësit pro-demokracisë shkuan në Gjykatën e Lartë të dielën në mëngjes duke kërkuar një urdhër urgjent kundër ndalimit të maskave por kërkesa e tyre u hodh poshtë.

Carrie Lam, shefja ekzekutive e Hong Kongut tha se rregullorja e re, e cila hyri në fuqi të shtunën, është një "ndalim për mbulimin e fytyrës" dhe ka për qëllim "të verë në shënjestër rebelët ose ata që përdorin dhunën".

Ligji i ri kërcënon këdo që vesh maska në protesta me burgim

deri në një vit. Banorët e Hong Kongut ende mund të veshin maska në rrugë, por sipas ligjit të ri, ata duhet t'i heqin maskat nëse u kërkohet nga policia.

Ndalimi i maskës për fytyrën ka edhe përjashtime për ata që kanë nevojë të ligjshme të veshin maskë.

Maskat për fytyrën janë bërë të zakonshme gjatë protestave në Hong Kong, madje edhe në marshime paqësore, pasi njerëzit kanë frikë nga ndëshkimi nga zyrtarët e qeverisë ose nëse identiteti i tyre mund të ndahej me Kinën kontinentale. Shumë banorë të Hong Kongut gjithashtu mbajnë maska për t'u mbrojtur nga ndotjet ose



infeksionet, siç është shpërthimi i sindromës vdekjeprurëse të rëndë të frymëmarrjes (SARS) që goditi qytetin në vitin 2003.

Për katër muajt e fundit, qyteti është përfshirë në trazirat ndër-

sa mbrojtësit e demokracisë u angazhuan në taktika gjithnjë e më konfrontuese për të luftuar kundër asaj që ata shohin si përpjekje të Kinës për të kufizuar autonominë e Hong Kongut dhe liritë civile.

# Presidenti Trump sulmon senatorin republikan Mitt Romney

Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump e sulmoi ashpër senatorin republikan Mitt Romney, të cilin e quajti të kapardisur dhe një naiv që po bie plotësisht në prehrin e demokratëve

**WASHINGTON, 6 TETOR** - Fundjva nuk po shërben si një pushim për betejën e hetimit për shkarkimin e presidentit Donald Trump. Ai shkroi disa mesazhe të forta në Tëitter, duke sulmuar si demokratët, ashtu edhe anëtarë të rëndësishëm të partisë së tij republikane.

Presidenti Trump e sulmoi ashpër në Tëitter senatorin republikan Mitt Romney, të cilin e quajti të "kapardisur" dhe një "naiv që po bie plotësisht në prehrin e demokratëve".

Arsyeja kishte të bënte me reagimin e senatorit Romney, ndaj këtij komenti të presidentit Trump.

"Kina duhet t'i hetojë Biden-at", u tha gazetarëve presidenti Trump të enjten.

Senatori Romney shkroi në Tëitter se "thirja e paprecedentë dhe pa takt drejtuar Kinës dhe Ukrainës për të hetuar Joe Biden-in është e gabuar dhe revoltuese".

Ai është senatori i parë republikan që kritikon drejtpërsëdrejti sjelljen e presidentit Trump.




Të shtunën në mbërmje, senatorja Collins e shtetit Maine, iu bashkua me kujdes senatorit Romney. Megjithatë, asaj do t'i duhet të përballë me një betejë të vështirë për t'u rizgjedhur, senatorja Collins e quajti thirrjen e presidentit Trump drejtuar Kinës "krejtësisht të papërshtatshme". Megjithatë, ajo nuk tha nëse presidenti Trump ka bërë shkelje duke i bërë presion Ukrainës për të hetuar Biden-at.

"Unë do të jem në rolin e anëtares së jurisë, siç isha gjatë gjykimit të presidentit Clinton. Prandaj nuk

dëshiroj të paragykoj evidencën, e cila nuk është marrë ende e tëra", u tha gazetarëve senatorja Collins. Siç pritej, demokratët po e kritikojnë më haptazi presidentin Trump, në veçanti ata që kandidojnë për zgjedhjet presidenciale.

"Ky president ka vënë interesat e tij të biznesit, interesat e tij politike, si dhe interesat e tij partiake, mbi interesat e vendit", deklaroi Amy Klobuchar, kandidatja demokrate për zgjedhjet e ardhshme presidenciale.

"Le të jemi të qartë - këtu shohim



qartë një shkarkim të ardhshëm, me kollare të kuqe", tha kandidatja demokrate Kamala Harris.

Në vazhdim të hetimeve, komisionet e Dhomës së Përfaqësuesve pritet të dëgjojnë nga dy diplomatë amerikanë.

Të martën pritet të paraqitet ambasadori amerikan në Bashkimin Evropian, ndërsa të premten, do të dëgjohet Marie Yovanovitch, ish-ambasadorja amerikane në Ukrainë, e larguar nga kjo detyrë nga presidenti Trump.

Sekretari amerikan i Shtetit Mike Pompeo tha se Departamenti i Shtetit do të bashkëpunojë, por pa tejkaluar masën.

"Ka pasur hetime nga Kongresi që i kanë shqetësuar dhe abuzuar punonjësit e Departamentit të Shtetit, duke i kontaktuar drejtpërsëdrejti dhe duke u kërkuar të ofrojnë dokumente që janë pronë e Departamentit të Shtetit. Kjo është përndjekje, dhe unë nuk do të lejoj kurrë që t'i ndodhë ekipit tim", deklaroi nga Athina, Sekretari amerikan i Shtetit.

## Kaos dhe përmbytje në Britani

**LONDËR, 6 TETOR** - Britania e Madhe është përfshirë nga moti i keq dhe përmbytjet. Reshjet e shiut vijnë me intensitet të lartë, ndërkohë që ekziston rreziku i përmbytjeve në disa qytete të vendit.

Sipas meteorologëve, në vetëm

pak orë ka rënë sa për dy javë shi dhe kjo situatë duket se i ka gjetur të papërgatitur britanikët.

Shërbimi meteorologjik ka shpallur alarmin e "verdhë" si dhe ka deklaruar që priten reshje më të dendura në ditët në vijim. Gjithashtu u theksua se për

shkak të përmbytjeve, njerëzve mund t'u rrezikohet jeta, ndaj duhet të tregohen të kujdesshëm.

Së fundmi, ishulli është përfshirë nga shira të stuhi të fuqishme dhe pritet që situata të rëndohet edhe më tej.







## AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla  
"RITMO - L"  
Prishtinë**

**Eksperienca jonë  
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:  
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:**

**044 248 173**

**044 200 604**


**044 375 333**



E jashtëzakonshme

## Breshkës i gjenden 104 copa plastike vdekjeprurëse në stomak

Rreziku dhe zhdukja e disa gjallesave vjen nga dora e njeriut dhe mungesa e ndërjegjësimi. Në një plazh të Floridës u gjet një breshkë e vogël në stomakun e së cilës u zbulua se kishte 104 copa plastike vdekjeprurëse. Zbulimi shkatërrues u raportua nga Qendra e Natyrës



Gumbo Limbo në Boca Raton, sipas një postimi të publikuar në rjetin social "Facebook".

FOTO E DITES



Një staf i kampit në Myanmar ushqen një elefant foshnjë katër muajsh. /Reuters/

E rrallë

## Liqeni ku natyra kthehet në skulptore kristalesh

Një nga vendet më të mira që duhen vizituar në dimër është, ndoshta, liqeni Baikal në Rusi. Ky vend është më fantastik në shkurt e në mars, kur liqeni është ngrirë dhe temperaturat janë disa gradë nën zero. Por, në të njëjtën kohë, ajri është i thatë dhe qielli është çuditërisht plot diell dhe pa re. Të gjitha këto kushte krijojnë pamjet më



fantastike në një prej liqeneve më të mëdhenj e më të pastër në botë.




**DASHI**

Nuk do të mungojnë idetë e reja dhe energjia e duhur për të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme dhe për të kaluar një ditë sa më të këndshme.



**DEMI**

Situatat spontane do t'ju bëjnë ditën edhe më të këndshme.



**BINJAKËT**

Ka gjasa të ndiheni pak të tensionuar gjatë ditës së sotme.



**GAFORRJA**

Duhet të gjeni kohë mjaftueshëm për t'u relaksuar, pasi lodhja mund t'ju çojë drejt pesimizmit.



**LUANI**

Sot do të ndiheni shumë të lumtur. Kjo vjen nga disa qëllime të arritura kohët e fundit.



**VI RGJËRESHA**

Mos humbisni kohën duke qëndruar në shtëpi. Dita është e bukur dhe shfrytëzoheni.



**PESHORJA**

Marrëdhëniet tuaja shoqërore do të jenë për më së miri.



**AKREPI**

Gjatë ditës së sotme do të ndiheni shumë optimist.



**SHIGJETARI**

Nëse bëheni subjekt i kritikave nga miqtë dhe familjarët për veprimet tuaja, mos u irritoni.



**BRICJAPI**

Nëse dëshironi të kaloni një ditë të qetë me familjen duhet ta rregulloni patjetër agjendën tuaj.



**UJORI**

Përpiquni të distancoheni nga debatet mes miqve apo kolegëve.



**PESHQIT**

Bëni kujdes me dietën ushqimore, pasi ekziston mundësia të mos ndiheni mirë.

## BARSOLETA E DITËS



Së shpejti martesat do të duken kështu:  
Ofiqari: A pranoni që ta ndryshoni statusin tuaj në 'Facebook' nga single në married.  
Nusja: Po.  
Ofiqari: I lus kumbarët të afrohen dhe të klikojnë like!



## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

### Çdo ditë në ora 16:00 Toy Story 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi;  
1 orë 40 min

**Rolet:** Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Madeleine McGraw (Bonnie), Christina Hendricks (Gabby Gabby), Don Rickles (Mr. Potato Head), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.

**Regjia:** Josh Cooley



### Në ora 18:00 dhe 20:00

## AD ASTRA

Aventurë/Dramë/Mister; 2 orë 04 min

**Rolet:** Brad Pitt, Tommy Lee Jones, Ruth Negga, Liv Tyler, and Donald Sutherland

**Regjia:** James Gray




### Çdo ditë në ora 22:00

## DOWNTON ABBEY

Dramë; 2 orë 02 min

**Rolet:** Hugh Bonneville, Jim Carter, Michelle Dockery, Elizabeth McGovern, Maggie Smith, Imelda Staunton, Penelope Wilton, etj.

**Regjia:** Michael Engler



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



## Angelina Jolie e pranon se e humbi pak veten pas ndarjes nga Brad Pitti



**A**ngelina Jolie 'humbi veten pak pas divorcit'. Ylli i Maleficent u nda nga Brad Pitti në vitin 2016 dhe ajo pranon se nuk e njohu veten me të gjitha ato që ndodhën. "Nuk e di se çfarë mban fati im, por

ajo për të cilën jam e bindur është se jam në një periudhë tranzicioni, si kthim në rrënjët e mia, një kthim në veten time. Sepse unë e kisha humbur veten pak", ka thënë ajo për revistën franceze "Madame".

## Jennifer Lopezi shëtiti pa grim rrugëve të Nju Jorkut



**A**ktorja e Hustlers, Jennifer Lopez, doli me një veshje më të thjeshtë gjatë një shëtitje në qytetin e Nju Jorkut të premtën. Duke stiluar flokët e saj në majë të kokës, talentja 50-vjeçare dukej e

lumtur dhe e qetë derisa ecte pa grim, njofton "Klan Kosova". Jenniferi bëri bujë me filmin e saj striptist "Hustlers", por ky u ndalua në disa shtete për shkak të përmbajtjeve nudo.



## Blake Lively bëhet nënë për herë të tretë

**A**ktorja 32-vjeçare Blake Lively është bërë nënë për herë të tretë. Por, çifti i famshëm s'e ka bërë publike ardhjen e foshnjës në jetë. Një burim i afërt e ka konfirmuar për revistën "Us Weekly" se foshnja e Blake Lively dhe Ryan Reynolds është tashmë dymuajshe. Aktorja

32-vjeçare e kishte zbuluar në muajin maj se ajo dhe aktori 42-vjeçar janë në pritje të fëmijës së tyre të tretë në premierën e filmit "Pokemon Detective Pikachu" ku luan bashkëshorti i saj. Lively kishte zgjedhur të vishte një fustan të verdhë që vinte në pah barkun e saj të fryrë.

## Artisti i njohur pëson aksident me motor

**Z**ac Hanson ka folur për gjendjen e tij pasi është lënduar në një aksident me motor gjatë kësaj jave. Këngëtari 33-vjeçar, më i riu nga vëllezërit Hanson, ishte duke planifikuar një udhëtim me motorin e tij kur përplasja ndodhi në Oklahoma. "Të mërkurën isha i përfshirë në një aksident me motorin tim derisa po për-gatitesha për një udhëtim. Megjithëse përfundova me tre brinjë të thyera, asgjë nuk është serioze. Do të shërohem me pak



pushim dhe kohë", ka shkruar Zac në rrjetet sociale.



# TË DYJA DYJA BIONDE DHE TË BUKURA Ivanka dhe Tifania 'e harruar' bëjnë jetë kaq të ndryshme



Ato ndajnë të njëjtin baba të famshëm, por dy vajzat e Presidentit amerikan Donald Trump Ivanka dhe Tiffany nuk mund të kishin jetë më të ndryshme se kaq.

Ndërsa nëna e tre fëmijëve Ivanka, 37 vjeçe, është këshilltare me kohë të plotë për babanë e saj, Tiffany, 25 vjeçe, ka qëndruar kryesisht jashtë vëmendjes dhe madje është quajtur edhe 'Trump e harruar'. Motrat, të cilat kanë nëna të ndryshme, shoqërojnë shpesh babanë e tyre nëpër vizita ndërkombëtare, por Tiffani gjithmonë mban një profil më të ulët dhe asnjëherë nuk i afrohet elegancës së Ivanka, e cila



në çdo dalje publike lë pas Duke bërë vazhdimisht një jetë zërat të flasin për të. publike, nuk është për t'u

habitur që Ivanka ka miqësi me njerëz të famshëm.

Ajo ka miqësi me Hugh Jackman, Natalie Portman, Karlie Kloss dhe Chelsea Clinton, vajzën e ish-presidentit amerikan Bill Clinton.

Tiffany, mund ta ketë kaluar pjesën më të madhe të jetës së saj larg vëmendjes së medias, por kjo nuk do të thotë që ajo nuk ka shokë të famshëm ... në fakt, duket se është e kundërta. Njerëzit e famshëm me të cilët shoqërohet vajza e presidentit përfshijnë aktoren Lindsay Lohan, vajzën e Gene Simmons Sophie, stilistin Adam Warren dhe vëllanë e Paris Hilton, Barron. / *The Sun*





# FBI i quan teori konspirative: Gangsteri amerikan u vra "gabimisht", zhvarrosen eshtrat

Autoritetet në Indiana të SHBA pranuan një kërkesë për të zhvarrosur eshtrat e gangsterit të njohur të viteve 1930, John Dillinger. Familjarët e Dillinger kishin kërkuar leje për të kryer këtë procedurë pasi dyshojnë se në varrezat e Croën Hill në Indianapolis nuk prehet trupi i gangsterit të njohur, por i dikujt tjetër.

FBI bën me dije se John Dillinger u vra nga agjentët e saj në vitin 1934 në Çikago dhe trupi i tij u vendos në varrezat e kryeqytetit të Indianas. Por nipi i tij, Michael Thompson dhe anëtarë të tjerë të familjes

besojnë se FBI vrau njeriun e gabuar në Teatrin e Çikagos në vitin 1934.

Ata deklarojnë se kanë prova se personi që ndodhet në varr është i gabuar duke thënë se ai ka pasur ngjyrën e syve ndryshe dhe gjithashtu dhe shenjat e gishtërinjve. FBI i hedh poshtë këto argumente duke i quajtur një teori konspirative.

John Dillinger është një nga gangsterët e njohur të viteve 1930 nga i cili mori frymëzim dhe filmi i fundit i Hollywood "Armiku Publik". Ai dhe banda e tij akuzoheshin për grabitjen e disa bankave në atë kohë.



## U shua në aksident, dalin në ankand 21 makinat e aktorit, Paul Walker

Një koleksion prej 21 automjesh në pronësi të aktorit të ndjerë Paul Walker janë vendosur të shiten në ankand me rastin e 49-të vjetorit të firmës së njohur Barrett-Jackson Scottsdale.

I njohur më shumë për rolin e tij si Brian O'Conner në filmin e famshëm Fast and the Furious, Walker ishte një fans i zjarrtë i makinave i cili humbi jetën gjatë një aksidenti me një Porsche Carrera GT në vitin 2013.

Të përfshira në shitje do të jenë pesë makina të rralla BMË E36 M3 Lightweights, të cilat u ndërtuan në një prodhim special nga BMË për Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Craig Jackson, kryetar dhe CEO i Barrett-Jackson, është shprehur se ankandi është projektuar për të përzgjedhur shtëpitë e reja për këto automjete shkruan Reppubblica.it.

Pjesë e ankandit do të jetë veçanërisht, makina e cila ka bërë më shumë bujë, përg-

jatë filmit 'Fast dhe Furious 5', një Nissan 370Z, e cila u bë pjesë e 'koleksionit' të makinave që ekipi grumbulloi në film. Ankandi do të zhvillohet në datat 11-19 Janar 2020.

### 21 MAKINAT E AKTORIT TË NJOHUR


- 1963 Chevrolet Nova Wagon
- 1964 Chevrolet Chevelle Wagon
- 1967 Chevrolet II Nova
- 1988 BMW M3 E30
- 1989 Nissan R32 Skyline Race Car
- 1991 BMW M3 E30 Coupe
- 1995 BMW M3 E36 Lightweight
- 1995 BMW M3 E36 Lightweight
- 1995 BMW M3 E36 Lightweight
- 1995 BMW M3 E36 Lightweight
- 1995 BMW M3 E36 Lightweight
- 1995 Ford Bronco SUV
- 2000 Audi S4
- 2003 Ford F250 Pickup
- 2004 GMC Sierra 1500 Pickup
- 2005 Harley-Davidson RS Motorcycle
- 2006 Toyota Tundra Pickup
- 2008 Suzuki Motorcycle
- 2009 Nissan 370Z
- 2011 BMW Motorcycle
- 2013 Ford Mustang Boss 302S Race Car





# Në Janinë, një nga qytetet më

Në kuadër të 70-vjetorit të ndarjes nga jeta të Mid'hat Frashërit, Instituti i Studimeve Historike "Lumo Skëndo" promovoi të enjten vëllimin e katërt të veprës së tij. Këto pjesë janë marrë nga libri i autorit të shquar shqiptar



Nga Mid'hat FRASHËRI

## NE JANINE

Kur hyjmë në Janinë, ora kish vajtur një e natës dhe mezi shohim udhën, që shkojmë dhe miqtë që na kanë dalë përpara. 15 vjeshtë parë 1909. Kur ngrihem, më e para e punëve është të nxiroj në dritare dhe të hedh një vështrim jashtë, të shoh këtë qytet, këtë Janinë kaq të dëgjuar. Nga shtëpia, ku jam, shoh një pjesë të madhe të qytetit, kënetën atje poshtë dhe malin Miçqel të zhveshur e të kuqreshëm m'anë tjetër. Por kam nxit, që të dal dhe ta shoh më mirë këtë qytet; dua të kuptoj a më ka mbetur ndonjë kujtim i vogël nga kohët e foshnjërisë, që kam shkuar atje. Me afër 30 mijë njerëz, Janina është një nga më të bukurit qytet të Shqipërisë, nga më të pastërtit dhe më të qytetëruarit. Rrugët, tek ecën, i gjen të ndrequra dhe të rregullta, sado që të shtruara me gurë të fortë; nuk janë rrugë qerreje, po edhe këto qerre nuk janë në Janinë. Vizita e parë është për në klub, pastaj për në shtypshkronjën shqipe të

gazetës "Zgjimi i Shqipërisë", çelur nja dy muaj pas konstitucionit; klubi ka hedhur një dritë të madhe shqiptarizmi në këtë qytet dhe ka zgjuar shumë ndjenja kombiare, që flinin në dremetje. Por dhe akoma sa punë e madhe, sa mundim të palodhur duhet që të dalin në dritë gjithë ndjenjat e fshehura dhe të panjohura të mëmëdhetarëve tanë të Janinës. Kur dëgjon njeriu kuvendimin e janotëve pandeh se gjuha e tyre është greqishtja. Po me sa çudi t'ëmbël kemi vrejtur se, në mos të gjithë, po të paktën gjysma e njerëzisë në Janinë e kupton dhe e flet shqipen. Pastaj pyetni një herë më ç'anë janë, nga vijnë Janinotët dhe do të kuptoni se kush është nga Çamëria, kush nga Labëria, tjetri nga na hidhëron zemrën! Se është faji ynë dhe vetëm yni: nuk kemi dashur që të qëndrojmë në këmbë, po jemi unjur pak. Tregu ka dyqane të mirë dhe lëvizje të mjaftueshme: duket se do të ketë shumë marrëdhënie. Po si më thonë: ku është tregtia që bëhej tridhet a dyzet vjet më parë, ahëre që Thesalia akoma s'ish dhënë te Greqia! Qytet i moçëm, mbase dhe në shekuj të parë, emëruar Dodonë, ashtu si kuptohet nga zënit ngoje te "Episkopia e Dodonës". Janina merr emrin, që ka sot dhe zihet në gojë për të parën herë më 1807 prej historishkronjësës Ana Komneni:



n'atë kohë shohim se princi norman, Boemondi, e mori nën urdhër të tij Janinën për pak kohë, mbretëri e këtyre princërve katolikë që fort e shkurtër n'Epir. Por pa shkuar shumë, Janina bie në short të despotit t' Epirit, një principat' e themeluar më 1206 prej Mihal Dukas, me kryeqytet Nartën. Si u ndodh dhe pak kohë nën sundim të serbëve, që erdhën dhe ranë si një breshër me mbretin Stefan Dushan, në Janinë gjejmë një familje princash shqiptarë, familjen e Topiasve, të cilët pastaj e lanë vendin me ca familje princash të vegjël gjer më 1396. Janina jepet vetvetiu te Sulltan Bajaziti i parë, një denie në paqë, që më pastaj u forcua edhe me luftë në kohë të Sulltan Muradit të dytë më 1431. Që ahëre, pa histori dhe pothuaj e shuar dhe e harruar, Janina merr një shkëlqim dhe emër të fortë me

Ali Pashën, në kohë të cilit thonë se kish gjer më 40-50 mijë njerëz. Edhe tek shëtit në këto rrugë, po mejtohem se tridhjetë vjet më parë, ky qytet kaq i vlefshëm dhe i dashur për të tërë shqiptarët, mënd na dolli nga dora, se diplomatët e Evropës në kongres të Berlinit e kishin parë t'udhës që t'i jepesh si dhuratë a si lëmoshë (sada-ka) Greqisë! Edhe le të flasë pastaj njeriu për shpirtmadhësi dhe drejtësi t'Evropës, të kësaj shoqërie të madhe, për të cilën vetëm një fjalë ka dëftesë dhe shpirt: interes! Këta kujtime të hidhura bëjnë dhe subjektin e fjalës sonë në vizitat që bëjmë te miqtë, subjekte të hidhura vërtet, po prej të cilave dilte dhe kuptohej nevoja e madhe që kemi, për të punuar dhe për të mos fjetur. Të punuar, të punuar pa dëshpërim dhe pa lodhje! Ky është edhe kuvendi, që rrjedh në klub, ku pas darke, përpara më tepër se njëqind e pesëdhjetë shpirt kam nderin, që të jap shpjegim nga kongresi i Elbasanit, si mëkëmbës që më kish dërguar klubi.

## SHKRONJAT SHQIP

Thamë në numrin që shkoi, se çështjen e shkronjave më s'kemi për ta trazuar, se na duket m'e udhës të përgjigjemi me punë sesa me fjalë. Vërtet, për ne përgjigja me të heshtur se me të punuar, na ngjan fort m'e dobishme dhe m'e fortë sesa polemika me fjalë të kota. Por ja se ku ngjarjet s'na lënë që të pushojmë: si e shkruam at'artikull, pamë se ca deputetë nga të Kosovës, Manastirit dhe Shkodrës bënë një shkresë dhe

e dhanë të sadrazemi, duke kërkuar që shkronjat shqip të ndalohen si të dëmshme për politikën e Shqipërisë dhe si vegla të intrigave. Në numrin e gazetës së javës që shkoi, duke dhënë këtë lajm të çuditshëm, thoshin se asnjë nga këta të katërmbëdhjetë zotërinj, që kanë nënshkruar atë shkresë, nuk dinë as të këndojnë as të shkruajnë shqip. Pa dyshim, këta zotërinj s'e kanë lodhur kurrë ndonjëherë mendjen, që të mejtohen mbi nevojat e diturisë dhe mbi mirësit' e qytetërimit. Kur kënduam shkresën e tyre, na u duk se kemi përpara syve ndonjë gjyq të inkuizicionit të kohës së Mesme. N'ato kohëra priftëria kallëzonte dhe gjykonte si gjë kundër fesë çdo send që s'i pëlqente, çdo shpikje të diturisë dhe çdo pemë të mendimit dhe të gjykimit: librat e të diturve, shkrimet e filozofëve, ahëre hidheshin në zjarr dhe zotërit e tyre gjykoreshin si magjistarë dhe si të pafe. Sa vepër të vlefshme dhe sa njerëz të pafajshëm e të vyer janë burgosur dhe hedhur në zjarr të gjallë prej atyre priftërinjve, që bënin të shenjtëruarën shoqëri t'inkuizicionit. Kur këndova shkrimin e atyre deputetëve, m'erdhi turp nga vetja ime se m'u kujtua gjyqi i inkuizicionit dhe verbëria fanatike e tij. Edhe themi se rrojmë në këtë kohë që bota gjetkë rreh të shpikë vegla qysh të fluturojë, të ndrithet dhe të lumturohet njeriu! Po ky shkrim më kujtoi dhe gjëra të zeza të tjera të vendit. Më kujtoi që në malet tanë njerëz kanë derdhur gjak se s'duan atdheun, të tjerë janë vrarë





# të bukura të Shqipërisë



shqiptarët, –ata të mjerë shqiptarë që i kanë zgjedhur, duke pandehur se do të punojmë për të mirën e tyre, – të rrinë n'errësirë dhe në padie, të mos çelin sytë, të mos gëzojnë jetën, të mos qytetërohen, të mos bëhen njerëz! Me një fjalë, kjo dëshirë e atyre të katërbëdhjetë të ndershmve, është një këllhitje nga ana e padijes kundër qytetërimit, është një zihje e errësirës kundër diturisë, një luftë si e Hyrmyzit dhe e Ehrimanit të Persëve të moçmë, një luftë si e priftërisë në kohë të Mesme! Po çudia është se këta të ndershëm të punëve të tyre duan t'u japin një ngjyrë hipokrizie dhe lajke, duan të rrëfhem si miq të qeveria, si miq të turqve. Po nuk e di ç'do të thonë tani që edhe turqit (Hysen e Xhahidi në Tanin) qeshin e tallen me ta? Se, padyshim, turqit e dinë fort mirë: ai që nuk do dhe veten dhe kombin e tij, s'mund kurrë ndonjëherë të dojë të tjerët. Të katërbëdhjetë të ndershmit harruan që çështja e shkronjave është një çështje thjeshtë filologjike, edhe një çështje e mbyllur, se kongreset e Manastirit, Dibrës e të Elbasanit e kyçën dhe e mbaruan. Të katërbëdhjetë deputetët pandehën se në këtë çështje mund të përzihen edhe ata, me qenë se janë deputetë! E dinin fort mirë, që Shqipëria e Sipërme kish deputetë, se shumë herë shpresuam t'ua dëgjonim zërin dhe emrin e tyre në një punë që deshën mbrojtur të drejtat e vendit tonë. Atëherë këta të ndershëm s'dëgjoheshin fare, po kur u çel çështja e shkronjave dhe e gjuhës, u bënë si bilbila. Por shkresa nuk mjaftonte! Të katërbëdhjetë zotërinjtë van'e panë edhe sadrazemin dhe i dhanë shkresën me emra. Nuk e dimë ç'bëri sadrazemi, në ka qeshur nën mjekër apo jo? Po duam të dimë pse vanë te sadrazemi dhe me ç'mendje e

dhanë shkresën? Qëmoti bota jepte lajme te Hamidi, jepte dëshira te valiu, edhe ylepet jepnin shpjegime te shehri Emin. Po deputetët tanë pse vanë te sadrazemi? Po t'i lëmë këto "pse", se e dimë që nuk kanë përgjigje, a më mirë përgjigjen e merr vesh çdo njeri. Vetëm këndonjësve u këshillojmë të bëhen të rëndë. Një fjalë perse thotë: nuk turbullohet ujët e thellë me një gur. Edhe ne nga të tillë gurë nuk turbullohem. Ata që s'dinë, të thonë ç'të duan. Ne të shikojmë punët tonë, të përpiqemi për gjuhë, për mësim, për dituri. Mos ndahemi nga kjo udhë, se qëllimet tanë janë të mirë për kombin tonë. Ne duam dritë, atyre q'u dhembin sytë, le t'i mbyllin.

## TË PUNOJMË!

Nja tre muaj më parë, tek kthesha nga Manastiri, udhëtova n'udhë të hekurt me një deputet francez. Ky ish një zot nja gjashtëdhjetë vjeç, me mjekër të bardhë e të shkurtër dhe një bark të madh. Kishte qenë dhe shumë fjet më parë në Turqi dhe tani po vinte të shihte pas konstitucionit këtë vend, për të cilin ndjente një dashuri. Pa vonuar shumë u bëmë miq dhe shokë. Më rrëfeu qysh kish udhëtuar në Manastir, Resnjë, Ohër. Kish parë se vendi me njëzet vjet e tëhu kish mbrothësuar mjaft. Kish parë një mirësim të mjaftë, që nga udhëtimi i parë. Shoku im kish shpresë të madhe për pritimin e Turqisë dhe thosh se në pak kohë mund të bëhej një vend i lulëzuar. Fjala vetiu vajti te Shqiptarët. Deputeti bëri fjalë më shumë lëvdata për kombin tonë dhe më tha se n'udhëtimin e tij të vogël ish pritur shumë bukur prej disa bej shqiptarë. Mbi këtë pikë të fundit, e zgjatëm fjalën; thamë sesi e kanë shtëpinë të hapur këta zotërinj,

se kushdo mund të vijë pa u trembur se mos gjejë derën të mbyllur. Shoku im përnjëherë më tha: Kjo a do të mbajë shumë kohë akoma? Kjo pyetje na bëri që të mejtohem. Shqiptarët tani po prishin atë q'u la i ati, po vetë a fitojnë, këtë gjë q'e kanë sot a do ta mbajnë? Prindërit tanë kanë fituar në kohët e para dhe sot nipërit e stërnipit e tyre po prishin me të dy duart, po prishin pa vënë asnjë para më nj'anë dhe pa fituar asnjë para të re. Në Shqipëri nuk gjen dy njerëz që të kenë vënë pesë para më nj'anë: ata që fitojmë sot, e prishin të tërë, pa për nesër ka perëndia. Të kursyerit, të vënë më nj'anë dy të holla këtë gjë se dinë fare. Franca sot, n'është një vend, që ka më tepër begati dhe gjëllim se nga gjithë shtet e tjerë, kjo i vjen ngase njerëzia

linin të punonin si duhej. Edhe kështu dheu ka mbetur i shkretë, çifligjet kanë mbetur vetëm sa për emër dhe gjindja e tërë ka mbetur në varfëri. Kur themi gjindja kuptojmë tërë shqiptarët dhe ata që na duken pak si të pasur, edhe ata vetë e dinë sesi kthehen. Është një gjë e ditur që nga koha e Adamit, se puna sjell bagëti; për të qenë i pasur, njeriu duhet që të punojë, pra s'duhet gjë tjetër; le të themi që kam nj'arë të shkretë që sot bën dhjetë lira, nesër në e punofsha, në mbjellsha ca pemë, n'e thursha me një gardh, në hapsha ca hendeqe, ajo arë do të më bëjë njëzet e pesë lira! Gjer më sot të zotërit e çifligjeve shkonin një herë në mot në çiflig, jo për të shikuar punën por për të marrë haselatin dhe për të ngrënë pula e pata. Nga ky shkak një çiflig që



në Francë është më ekonomike se tekdo gjetkë, se njerëzia na atë vend është mësuar që të vërë gjithnjë ca të holla më nj'anë. Tridhjetë e tetë vjet më parë, si u mund në luftë Franca i pagoi Gjermanisë dyqind e pesëdhjetë miliona lira frëngu: Kjo është një shumë e madhe, po Franca në shumë pak kohë e mblodhi veten prapë. Të hollat që vihen më nj'anë s'rrinë të ndryshken po gjithnjë pjellin të holla të tjera, gjithnjë prodhojnë. Ata shoqëri të mëdha, fabrikat dhe gjithë ato punë të mjeshtërisë janë bërë më të holla, jo me të holla të një njeriu a disa njerëzve, po me të hollat e botës, me kapitale të mbledhura çika çika nga njëri te tjetri. Gjer më sot mesa shqiptarë kemi kuvenduar për këtë punë, na thonë se gjithë shkaku dhe gjithë faji ishte qeveria e ligë, se njeriu s'ishte i lirë që të punonte, t'udhëtonte për tregti a të shikonte çifligun; Hajdutët, xhandarët dhe mehmurët që kishin tmerruar vendin dhe s'i

mund të jepte një mijë lira, tani jep vetëm dyqind lira, edhe ato me një njëmijë mundime. Fjala thotë: sa të kesh jorganin aq zgjat këmbët, por ata që kanë çiflig ndër ne, këmbët i nxjerrin dhe një pëllëmbë jashtë shtresës. Në vend që të punojmë e të përpiqen për të shtuar fitimin e tyre, ata prishin me të dy duart, prishin për qejf dhe për marrëzi; edhe çifligu pas dy vjetësh vete rehen dhe djali s'gjen as pesë para kur vdes i ati. Një gjë që në Shqipëri s'e kemi kuptuar fare, është se çifligu është si një dyqan, duhet që ta shikojë i zoti vetë dhe jo ta lerë në duart e subashëve. Këto dhe shumë të tjera thamë me shokun udhës, dhe që të dyve na erdhi pyetja: Pse njerëzit e vendit tonë janë kaq armiq të gjësë së tyre? – Shkaku i kësaj pune është që në Shqipëri këta çifligje që pe si kanë fituar vetë që t'ua dinë vleftën. Këto i kanë fituar prindërit dhe bejlerët sot prishin sikur është gjë e armikut.



se s'duan rrugë qerreje dhe udhë të hekurt, të tjerë janë therur te millet bahçe te xhamia ... dhe të tjerë kanë luftuar se s'duan as të paguajnë te qeveria, as ushtarë të venë. Po ja se ku deputetët tanë sot na thonë se s'e duan gjuhën shqipe! Mos pandehet se të ndershmit katërbëdhjetë deputetë t'asaj shkresë s'i duan shkronjat shqip, ata s'duan as gjuhën, ata thonë që gjuhën shqipe ta lëmë fare. Këndoni shkresën, këndonin dhe dy artikuj të deputetit të Pejës dhe do të kuptoni se këta të ndershëm zotërinj e mohojnë fare gjuhën tonë: sikur të kishin fuqi, do të kërkonin të na prinin me gërshërë që nga rrënja. Pse? Këndoni historinë e inkuizicionit dhe do ta kuptoni! Shkrimet e këtyre të ndershmëve deputetë, për atë që di të këndojë, thonë: ne s'duam të jemi shqiptarë, ne duam që



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

# Manaj: Kujdes nga 'Nikli', është kampion në fuqi

Trepça '89 - Feronikeli dhe katër ndeshje të tjera të javës së nëntë në elitën e futbollit të Kosovës zhvillohen sot (e hënë) nga ora 14:30. Futbollisti Arb Manaj ka thënë se "Nikli" ka skuadër të fortë, por që 89-shi do të hyjë me përqendrim maksimal. "Na pret një ndeshje mjaft e fortë ndaj kampionëve të Kosovës, por ne e kemi harruar ndeshjen e fundit dhe jemi përgatitur që të hyjmë në këtë ndeshje me përqendrim maksimal. Pavarësisht prej disa lëshimeve, Feronikeli është kampion në fuqi dhe ka një skuadër me lojtarë cilësorë dhe është më i fortë se në vitin e kaluar", ka thënë Manaj



**EPOKA E RE** **Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 6 TETOR** - Pesë ndeshjet e javës së nëntë në IPKO Superligën e Kosovës në futboll zhvillohen sot (e hënë). Një nga ndeshjet kryesore do të zhvillohet në Mitrovicë, ku Trepça '89 e pret Feronikelin. Të dyja skuadrat kanë pësuar humbje në ndeshjet paraprake dhe tash kërkojnë t'u rikthehen fitoreve. Arb Manaj, që po shkëlqen në këtë edicion me fanellën e '89-shit, ka thënë për "Epokën e re" se skuadra e tij e ka harruar humbjen e pësuar në Klinë në përballje me Dukagjinin dhe tash është përgatitur për ndeshjen ndaj "Niklit". Ai ka shprehur bindjen se skuadra nga Drenasi, edhe përkundër disa lëshimeve në ndeshjet e fundit, është edhe më e fortë se në edicionin e kaluar. "Na pret një ndeshje mjaft e fortë ndaj kampionëve të Kosovës, por ne e kemi harruar ndeshjen e fundit dhe jemi përgatitur që të hyjmë në këtë ndeshje me përqendrim maksimal. Pavarësisht prej disa lëshimeve, Feronikeli është kampion në fuqi dhe ka një skuadër me lojtarë

cilësorë dhe është më i fortë se në vitin e kaluar", ka thënë Manaj, i cili ka treguar edhe për mungesën e vetme të skuadrës mitrovicase në këtë ndeshje tepër të rëndësishme. "Ne kemi mungesën e Ardian Mujës, i cili u lëndua në ndeshjen e kaluar që u rikthye pas një kohe të gjatë. Ne i urojmë shërim të shpejtë dhe të kthehet në skuadër, pasi skuadra ka nevojë për të", ka shtuar ai.

Skuadra e Feronikelit ka pësuar humbje befasuese në mesjavë nga Llapi (1-2). Për ndeshjen që zhvillohet në stadiumin "Riza Lushta" foli për gazetë edhe futbollisti i Feronikelit, Albutrint Morina, duke bërë me dije se skuadra kampione në çdo ndeshje shkon për fitore. "Ndeshja e radhës do të jetë shumë e vështirë kundër Trepçës '89, e cila si vendëse luan një futboll të mirë, por ne jemi kampionë aktualë dhe normalisht se do të shkojmë për fitore në çdo ndeshje, përfshirë edhe këtë në Mitrovicë", ka thënë Morina.

Trepça '89 është në pozitën e shtatë me 9 pikë, kurse Feronikeli pozicionohet në vendin e katërt me 15 pikë. Të shtunën është zhvilluar ndeshja e parë e kësaj

xhiro në mes të Llapit dhe Ferizajt. Skuadra mysafire arriti që të bëjë befasi në stadiumin "Zahir Pajaziti", pasi shënoi fitore me rezultat 2-4.

## IPKO SUPERLIGA

Llapi - Ferizaj 2-4

Të hënë takohen:  
Vushtrria - Ferizaj  
Ballkani - Prishtina  
Trepça '89 - Feronikeli  
Gjilani - Dukagjini  
Drenica - Drita

## LIGA E PARË

Të hënë takohen:  
Drenasi - Ramiz Sadiku  
Trepça - Malisheva  
Istogu - KEK-u  
Ulpiana - Besa  
Vëllaznimi - Vllaznia (P)  
Onix - 2 Korriku  
Arbëria - Vitia  
Liria - Dardana

## SHKURT

### 'Dardanet' zhvillojnë përgatitjen e parë në Tartu

Përfaqësuesja e Kosovës në konkurrencën e femrave e ka zhvilluar stërvitjen e parë në Tartu, ku do ta zhvillojë ndeshjen e tretë kualifikuese për "Euro 2021" në kuadër të Grupit A kundër Estonisë. "Dardanet" kanë një fitore dhe një humbje, derisa estonezet deri tash kanë luajtur tri ndeshje dhe kanë arkëtuar vetëm një pikë. Në stërvitje atmosfera tek futbollistet dhe stafi i përfaqësueses ishte shumë e mirë dhe të gjithë e presin me entuziazëm këtë ndeshje, me shpresë për ta realizuar fitoren e dytë në këto kualifikime. "Dardanet" do ta zhvillojnë të hënë stërvitjen e fundit, derisa të martën në orën 18:15 do ta zhvillojnë përballjen ndaj Estonisë.

### Kosova sot fillon përgatitjet për ndeshjet e tetorit

Përfaqësuesja e Kosovës në futboll sot (e hënë) fillon përgatitjet për dy ndeshjet e muajit tetor. "Dardanet" më 10 tetor zhvillojnë miqësoren kundër Gjibraltarit dhe katër ditë më vonë ndeshjen kualifikuese ndaj Malit të Zi. Ndërsa nga ora 11:00 përzgjedhësi Bernard Challandes do të mbajë konferencë për media në hotel "Emerald".

### Canë zyrtarisht largohet nga Vëllaznimi

Është zyrtarizuar largimi i Agim Canës nga posti i kryetarit të klubit Vëllaznimi nga Gjakova. Canë ia ka paraqitur dorëheqjen kryetarit të Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini. "Pasi që dorëheqja e tij e ofruar para më shumë se tre muaj nuk ishte aprovuar nga kryetari i komunës, Canë i ka paraqitur kryetarit të komunës dorëheqje të paravokueshme", thuhet në njoftimin e klubit kuqezi.

## FISU-ja vlerëson lart aktivitetet e FSUNK-së

**PRISHTINË, 6 TETOR** - Federata e Sporteve Universitare e Kosovës (FSUNK) më 20 shtator iu bashkua botës në celebrimin e "Ditës Ndërkombëtare të Sportit Universitar". Nën ombrellën e Federatës Ndërkombëtare të Sportit Universitar (FISU), FISU ka shënuar këtë ditë më shumë aktivitete sportive, ku morën

pjesë rreth 200 studentë. Për organizimin e kësaj dite FISU-ja e falënderoi FSUNK-në dhe kryetarin Musa Selimi për organizimin e mirë të kësaj dite. Ndër të tjera, në letërën e presidentit të FISU-së, Oleg Matytsin dhe sekretarit gjeneral të saj, Eric Saintrond, thuhet se festimi i kësaj dite në Kosovë është një

shembull i mirë për të tjerët. "Festimi i Ditës Ndërkombëtare të Sportit Universitar në Kosovë është një shembull i mirë i një anëtarit aktiv të FISU-së. Përmes aktiviteteve të ndryshme të organizuara për këtë ditë (IDUS), FSUNK ka kontribuar në mënyrën më të mirë të mundshme në zhvillimin e sportit uni-

versitar, duke u bërë kështu një shembull i mirë për anëtarët e tjerë", thuhet në letërën e FISU-së. FSUNK-ja është anëtar i dy federatave kryesore të sportit universitar: Federatës Ndërkombëtare të Sportit Universitar si dhe Federatës Evropiane të Sportit Universitar (EUSA).





## Fitore të reja për Prishtinën, Vushtrrinë dhe Prizrenin

**PRISHTINË, 6 TETOR** - Skuadra e Prishtinës ka shënuar fitore me rezultat të thellë ndaj Vëllaznimit të Gjakovës (44-26). Beshiri, Abazi e Bajqinovci ishin më efikasit në skuadrën kryeqytetase, kurse te Vëllaznimi më së shumti

gola realizoi Neziri. Në ndeshjen tjetër Vushtrria ka fituar ndaj Drenicës me rezultat 31-28. Pjesa e parë përfundoi 15-15, por në të dytën vushtrriasit arritën dy pikët e reja. Gubetini ishte i pandalshëm duke shënuar 14

gola. Te Drenica u dallua Kastrati me 11 gola. Fitoren e parë e shënoi Prizreni i kthyer në Superligë. Kjo skuadër arriti fitore në Podujevë ndaj Llapit me 31-25. Llapjanët përfunduan pjesën e parë në të mirë të tyre, me rezultat 13-

12, por në të dytën prizrenasit treguan më shumë. Mehmeti e Leka udhëhoqën Prizrenin, kurse Hoxha u dallua te Llapi. Ndeshja në mes të Besa Famgas dhe Dritës së Gjilanit është shtyrë me marrëveshje të dy klubeve.



## Reja: Në Turqi shkojmë për fitore

**TI RANË, 6 TETOR** - Shqipëria do të luajë dy ndeshjet e radhës për kualifikueset e Evropianit, atje ku prova më e vështirë dhe si një finale e vërtetë do të jetë ajo me Turqinë. Është publikuar edhe lista e kombëtares, atje ku ka pasur edhe disa surpriza të bukura me debutimin e Taulant Seferit apo të Lindon Selahit.

Trajneri i kuqezinjve, Edy Reja, ka shpjeguar zgjedhjet e tij, njëkohësisht ka bërë edhe një analizë për takimet që do të luhen në tetor. "Mavraj ka një problem me krahun dhe do të operohet këtë javë. Më ka kërkuar pushim. Ky është problemi dhe shpresoj që ta kemi gati për në nëntor. Sa i përket Sadikut, kishte një problem familjar, prandaj është lënë jashtë. Kështu u kemi dhënë hapësirë edhe lojtarëve të rinj si Selahi dhe Seferi, që janë për herë të parë në listë. Me Xhakën kemi folur dhe jemi sqaruar. Unë doja që t'i jepja më shumë kohë të rinjve. Dua t'i njoh më mirë. Turqia ka grumbulluar katër portierë, edhe ne aq. Nuk ekziston problem i veçantë për Berishën. Ne i kemi portierët në nivel shumë të lartë dhe unë kam shumë problem për ta vendosur titullarin. Shumë e rëndësishme që lojtarë të kenë minuta, por duhet marrë parasysh



edhe qëndrimi i tyre te Kombëtarja. Për shembull, Dermaku nuk luan te Parma, por te Kombëtarja tregon vendosmëri dhe gjeti golin", ka thënë Reja. Trajneri italian ka konfirmuar se Shqipëria synon fitore në ndeshjen ndaj Turqisë, pasi dy rezultatet e tjera: barazimi dhe humbja e lë jashtë evropianit. "Në Turqi do të shkojmë për ta bërë lojën tonë për t'i vënë në vështirësi dhe për të

marrë një rezultat pozitiv. Neve edhe barazimi na nxjerr jashtë. Kemi vetëm një shans, që të fitojmë me Turqinë. Kjo është mundësia e fundit që kemi për ta kapur Evropën. Gjithë ambienti është gati për ta marrë fitoren. Më pëlqen të luaj futboll, jo vetëm të mbrohem. Nuk më pëlqen që të marrim vetëm rezultate cinike. Më pëlqen ky grup dhe dua ta shoh të ardhmen e tij. Po përgatis një grup që ta përballoj intensitetin e lartë. Të humbësh ndeshjen direkte, atë ndeshje të parë në Shkodër, sigurisht se bëhet shumë herë më e vështirë. Dua ta veçoj, por ne nuk e kemi thënë ende fjalën e fundit. Për mua janë dy çështje që duhet të ecin me të njëjtin hap, kualifikimi dhe rinovimi i ekipit. Në Itali ka shumë shqiptarë që kanë lindur në trojet arbëreshe. Ne do të provojmë që t'i marrim të gjithë lojtarët që mundemi, pavarësisht se sa e vështirë është. Do të provojmë t'i marrim lojtarët që i shërbejnë kauzës shqiptare", ka shtuar Reja.

### LISTA E FUTBOLLISTËVE

E. Berisha, A. Hoxha, Th. Strakosha, G. Selmani, B. Gjimeshi, E. Hysaj, A. Ismajli, L. Trashit, M. Kumbulla, F. Veseli, E. Mihaj, K. Dermaku, L. Selahi, A. Abrashi, K. Bare, L. Memushaj, K. Gjasula, K. Qose, Y. Ramadani, E. Lenjani, B. Balaj, S. Cikalleshi, O. Roshi, R. Manaj, T. Seferi.

## Prishtina mposhti Pejën në derbi, Rahoveci deklasoi Lipjanin

**PEJË, 6 TETOR** - Në një atmosferë të jashtëzakonshme në "Karagaçi" me më shumë se 2 500 shikues, Sigal Prishtina ka shënuar fitore ndaj Pejës me rezultat 72:85 (13:20, 18:17, 24:24, 17:24). Përballja në Pejë ka qenë shumë interesante, derisa palestra ishte e mbushur me tifozë, ku tifozët pejanë krijuan një atmosferë shumë të mirë. Sidoqoftë, prishtinasit fituan çerekun e parë 13:20 dhe atë të fundit 17:24, derisa perioda e dytë dhe e tretë ishin të barabarta, 18:17 dhe 24:24. "Verdhezinjtë" rezistuan dhe luftuan aq sa mundën kurse, bardhekaltrit, duke shfrytëzuar përvojën, fituan në fund 72:85, që ishte fitorja e dytë në tri takime, derisa pejanët kanë një fitore dhe një humbje.

Te Peja u dalluan Henrik Sirko me 15 pikë, Malcolm Armstred me 14 dhe Albin Berisha me 13. Te Sigal Prishtina u veçuan Divine Myles me 22 pikë, Fahro Alihoxhiq me 21 pikë e nëntë kërcime, Mikaile Imusiq me 17



pikë dhe Dardan Berisha me 12 pikë, shtatë kërcime dhe nëntë asistime. Ndërsa Rahoveci ka shënuar fitoren e dytë në këtë edicion nga dy ndeshje të zhvilluara, pasi të shtunën mbrëma në shtëpi e ka mundur Lipjanin me rezultat 96:63 (28:15, 21:17, 21:14, 26:17). "Vreshtarët" kanë qenë më të mirë nga fillimi deri në fund dhe shënuan fitore të merituar, që ishte e dyta pas asaj

ndaj Sigal Prishtinës, derisa për Lipjanin kjo ishte humbja e tretë nga tri takime të zhvilluara. Javis Howard kishte 18 pikë e dhjetë kërcime për vendësit, derisa u ndihmua nga Arian Qallaku me 17 pikë dhe Lj Both me 15 pikë e nëntë kërcime. Te Lipjani u dalluan Demarkus Stuckey me 22 pikë, shtatë kërcime e dhjetë asistime dhe Marquise Simuels me 22 pikë.

### SHKURT

#### Marquezi e fitoi titullin e tetë në karrierë

Marc Marquezi është kampioni i botës për vitin 2019, pasi spanjoli siguroi matematikisht titullin në pistën e Tajlandës. Marquezi fitoi titullin e tetë në karrierë dhe të gjashtin në MotoGP. Skuadra e Hondas erdhi me një strategji fantastike në pistën e Tajlandës, pasi Marquezi pati një duel të fortë gjatë garës me Quartararon. Ky i fundit kryesoi garën pothuajse gjatë gjithë kohës por, në fund, në xhiron e fundit, kampioni i botës tregoi zgjuarsinë e tij dhe me përvojë i mori fitoren nga duart. Vinales plotësoi treshen e podiumit, ndërsa në vendin e katërt u rendit Dovizioso, Rossi e mbylli garën in teti.

#### Lëndohet Zappacosta, Roma rikthen interesimin për Hysajn

Davide Zappacosta iu bashkua Romës në afatin kalimtar veror si huazim nga Chelsea, por mbrojtësi i djathtë italian ka këputur ligamentet dhe do të mbetet jashtë fushave më së paku për gjashtë muaj. Kjo ka bërë që Roma tani të mendojë për një mbrojtës të ri. Mediet italiane kanë raportuar se Roma është rikthyer përsëri te pista e Elseid Hysajt. Në rast se Napoli e ul çmimin e shqiptarit në 15 milionë euro, atëherë Roma do ta tentojë transferimin e tij.

#### Modriqi mund të rikthehet në Tottenham

Fituesi i 'Topit të Artë', Luka Modriqi, mund të mos e ketë të gjatë aventurën e tij me skuadrën e Real Madridit. "ElDesmarque" raporton se ish-lojtari i Tottenham Hotspurit mund të rikthehet në Premierligë, pikërisht te "Spursi". Mesfushori mund të përfshihet në një marrëveshje që do ta transferonte Christian Eriksenin në "Santiago Bernabeu". Kroati kishte kaluar katër vjet në "White Hart Lane", para se të kalonte në Spanjë, ku me Real Madridin korri suksese të mëdha.

#### Golovkin mposht me pikë Derevyanchenkon

Gennady Golovkin ringrihet në çatinë e botës për peshat e mesme në boks në IBF. Boksieri kazak mposhti me pikë me vendim unanimit të jurisë në tempullin e boksit, Madison Square Garden, ukrainasin Sergiy Derevyanchenko (114-113 pikët e Frank Lombardit, 115-112 të Eric Marlinkit dhe Kevin Morganit). Derevyanchenko i shemb në tapet që në raundin e parë pas një të djathtë të fortë të Golovkin. Mirëpo ukrainasi jo vetëm se arriti të ngrihej, por arriti të rezistonte pavarësisht plagës mbi syrin e majtë, e shkaktuar nga një përplasjeje e pavullnetshme kokë me kokë. Beteja zgjati deri në raundin e fundit, me Derevyanchenko që tregoi se ishte ngjitur në ring për t'i hedhur poshtë parashikimet. Verdicti i gjyqtarëve kurorëzoi Golovkinin, që në moshë 37-vjeçare konfirmohet në majën e boksit.

#### Lëndohet Kroosi, mungon 3 javë

Problemet e Real Madridit me lëndime nuk kanë fund teksa një tjetër futbollist është dëmtuar të shtunën. Fjala është për mesfushorin gjerman Toni Kroos i cili ka pësuar një dëmtim në këmbën e majtë dhe pritet të qëndrojë larg fushave të lojës për rreth tri javë. Si pasojë e kësaj, Kroosi pritet të mungojë në ndeshjen kundër Mallorcas, Galatasarayt dhe është në dyshim për ndeshjen me Barcelonën më 26 tetor. Gjithashtu, do t'i humbë edhe ndeshjet me kombëtaren e Gjermanisë kundër Argentinës dhe Estonisë.





### Poziv za izražavanje interesa

Škola/Opština: METO BAJRAKTARI, REČANE, PRIZREN

Datum: **07.10.2019**,

Naziv ugovora: Negovanje i poštovanje svoje i kulture drugih zajednica na Kosovu  
Broj ugovora: **ESIP/SDG/087-CS/1.11**

Vlada Kosova je dobila kredit od grupe Svetske banke za Projekat poboljšanja obrazovnog sistema (PPOS), i namerava da deo sredstava iz ovog kredita izdvoji za podršku Ministarstvu obrazovanja, nauke i tehnologije i ONSŠ "METO BAJRAKTARI", PRIZREN Kao deo ove podrške sledeća nabavka potrebne opreme će se odvijati:

#### 1. Opis potrebne usluge:

Organizacija aktivnosti,  
Transport ucenika i nastavnika  
Hrana i osvezavajuće pice  
Spavanje  
Sala za rad

#### 2. Minimalni kriterijumi za kvalifikovanje izvođača radova da imaju pravo da se prijave su:

- Uspešno iskustvo u izvršenju najmanje 2 ugovora o robi slične prirode tokom poslednje dve godine;
- Pravna registracija firme od strane lokalnih vlasti.

3. Zainteresovani izvođači koji ispunjavaju navedene minimalne kvalifikacione uslove su dobrodošli da se prijave sa svojim izražavanjem interesa za detaljne tehničke specifikacije na adresi ONSŠ „Meto Bajraktari“ u Rečanu, 20530 Rečane, najkasnije do 15.10.2019. godine, do 14.00 časova.

4. Detaljna tehnička specifikacija, zajedno sa drugim uslovima, sve pripremljeno u jednom dokumentu pod nazivom Poziv za dostavu ponude za robu će biti dostavljeni od strane škole samo za one izvođače koji ispunjavaju kriterijume. Kompanije se mole da dostave svoje kontakt podatke prilikom podnošenja svog interesovanja.

Kontakt detalji škole: Esad Kurejšepi,  
+383 44 389 144 ,  
meto.bajraktari@outlook.com

### Njoftimi për shprehje të interesit

Shkolla: SHFMU "7 Shtatori"

Komuna: Pejë

Data: **07.10.2019**

Emri i kontratës: **Pako për pajisjen e kabinetit të TIK-ut.**

Numri i kontratës: **ESIP/C1.3/153 - ESIP/SDG/153-G1.1.**

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe SHFMU "7 Shtatori" fshati Vitomericë në Pejë.

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

#### 1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

- Fotokopje 1 copë
- Projektor 1 copë
- Tabela e mençur 1 copë

#### 2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

• Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;

• Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën SHFMU "7 Shtatori" në Vitomericë-Pejë më së largu deri më 15.10.2019.

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Emri i personit kontaktues:

**Lumnije Berisha**

Telefoni: **044 147 361**

E-mail: **lumi@hotmail.de**

### Prilog 5: Poziv za izražavanje interesa

#### Poziv za izražavanje interesa

Škola/Opština: **OiNSŠ „25. maj“ – Donje Ljubinje – Prizren**

Datum: **07. 10. 2019.**

Naziv ugovora: **Kupovina IT alata**

Broj ugovora: **ESIP/SDG/081-G/1.1**

Vlada Kosova je dobila kredit od grupe Svetske banke za Projekat poboljšanja obrazovnog sistema (PPOS), i namerava da deo sredstava iz ovog kredita izdvoji za podršku Ministarstvu obrazovanja, nauke i tehnologije i OiNSŠ „25. maj“ – Donje Ljubinje – Prizren. Kao deo ove podrške sledeća nabavka potrebne opreme će se odvijati:

#### 1. Opis potrebne robe:

**Kupovina IT alata**

**Laptop – 2 komada**

**Projektor – 2 komada**

#### 2. Minimalni kriterijumi za kvalifikovanje izvođača radova da imaju pravo da se prijave su:

- Uspešno iskustvo u izvršenju najmanje 2 ugovora o robi slične prirode tokom poslednje dve godine;
- Pravna registracija firme od strane lokalnih vlasti.

3. Zainteresovani izvođači koji ispunjavaju navedene minimalne kvalifikacione uslove su dobrodošli da se prijave sa svojim izražavanjem interesa za detaljne tehničke specifikacije na adresi **OiNSŠ „25. maj“ – Donje Ljubinje – Prizren** najkasnije **16. 10. 2019.**

4. Detaljna tehnička specifikacija, zajedno sa drugim uslovima, sve pripremljeno u jednom dokumentu pod nazivom Poziv za dostavu ponude za robu će biti dostavljeni od strane škole samo za one izvođače koji ispunjavaju kriterijume. Kompanije se mole da dostave svoje kontakt podatke prilikom podnošenja svog interesovanja.

Kontakt detalji škole:

Kontakt osoba: **Asim Karadolami**

Telefon: **044 528 030**

e-mail: **asim-76@hotmail.com**

### Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: **“Svjetlost”**

Komuna: **Prizren**

Data: **07.10.2019**

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
<b>ESIP/SDG/090-G/1.1</b>	<b>Pajisja dhe rekuizita sportive</b>

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles SHFMU "Svjetlosti" Manastirica, Prizren. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

#### 1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

- **Pajisje dhe rekuizita sportive**

#### 2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën e SHFMU "Svjetlost" Manastirica, Prizren, më së largu deri më 15.10.2019.

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-Mallra, do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: **Zijad Kulici**

Telefoni: **044/833-415**

E-maili: **o.s.svjetlost@hotmail.com**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.18/2019

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Naim Mehulli në çështjen juridike të paditëses: Atie (Elez) Tortoshi nga Mitrovica Rr. "Llovqinska", kundër të paditurit: Florim (Xheladin) Fejza nga Mitrovica, tani me adresë të panjohur, baza e kontestit: Besim i fëmijëve, gjykata me datën: 11.09.2019 konform nenit 79.3 të LPK-së mori këtë:

#### A K T V E N D I M

**I. Caktohet** përfaqësuesi i përkohshëm Av. **Elvir Imeri** nga Mitrovica si përfaqësues i përkohshëm i të paditurit: Florim (Xheladin) Fejza nga Mitrovica, tani me adresë dhe vendbanim të panjohur.

**II.** Përfaqësuesi i përkohshëm në kuptim të nenit 82 të LPK-se, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjorë, të cilat i ushtron deri sa të paraqiten në gjykatë i padituri apo përfaqësuesi me prokurë, respektivisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

**III.** Ky aktvendim në afat prej shtatë ditësh të shpallet në tabelën e shpalljes së gjykatës, të botohet në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe të botohet në njëerën nga gazetatat ditore të Kosovës apo sipas nevojës të shpallet në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme.

#### Arsyetim

Paditësja Atie Tortoshi nga Mitrovica ka parashtruar padi kundër të paditurit Florim Fejza nga Mitrovica, tani me vendbanim të panjohur, me objekt të padisë, besim i fëmijëve.

Paditësja ne seancën e datës 08.03.2019 i ka propozuar gjykatës që meqenëse i padituri gjendet në Itali dhe nuk i dihet adresa e saktë, të njëjtit të caktohet përfaqësuesi i përkohshëm.

Gjykata ka kërkuar nga Stacioni Policor Rajonal në Mitrovicë informatë rreth adresës për të paditurin Florim (Xheladin) Fejza nga Mitrovica, por nga njoftimi i Policisë së Kosovës-Stacioni Policor Mitrovicë me datën 23.07.2019 ka rezultuar se për të njëjtin kane dal për verifikimin e adresës dhe pas disa informatave të marra është konstatuar se për të njëjtin nuk dihet vendbanimi i saktë, dhe se për të njëjtin ka informacioni se ndodhet jashtë shteti.

Pas shqyrtimit të propozimit të të autorizuarit të palës paditëse, gjykata vlerësoi se ky propozim për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm të paditurit të cekur më lartë është i bazuar pasi që janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore të parapara me nenin 79.3 pika a) të LPK-se, ndërsa për përfaqësues të përkohshëm bazuar në propozimin e Odës së Avokatëve të Kosovës të dt.11.09.2019 ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm Av. Elvir Imeri nga Mitrovica.

Përfaqësuesi i përkohshëm në kuptim të nenit 82 të LPK-se, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjorë, të cilat i ushtron deri sa të paraqiten në gjykatë e paditura apo përfaqësuesi me prokurë, respektivisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Nga se u tha më lartë konform nenit 79.3/1, neni 82.1.2 si dhe nenit 387.1 të LPK-së vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
C.nr.18/2019 me date 11.09.2019

**GJYQTARI,**  
Naim Mehulli

UDHËZIM JURIDIK – Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshpeite](http://www.facebook.com/gjejpuneshpeite)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Arton Mavriqi shpall të pavlefshme dëftesën e vitit të I (parë) të shkollës së mesme "28 Nëntori" Prishtinë.
- ▶ N.SH. "D&D Business Support Center" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb. 71149153 dhe nr. fis. 600668662.
- ▶ Edona Maxhuni shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme "Dr. Xheladin Deda" në Mitrovicë.
- ▶ Ukë Salihaj shpall të pa vlefshme dëftesat e viteve X,XI,XII dhe diplomën e Sh.M. Ekonomike "Kadri Kusari" në Gjakovë
- ▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales